

## TOPONIMET KOMPOZITORE MESJETARE NË TË FOLMET E SOTME SHQIPE\*

Mehmet Halimi

Instituti Albanologjik  
i Prishtinës

KUD 809.3 (311)  
Punim studimor

Marrë për botim më 20 nëntor 1986

**Përmbajtja e shkurtër:** Në këtë punim bëhet fjalë për toponimet kompozitore mesjetare në të folmet e sotme shqipe, duke i marrë në shqyrtim toponimet e vendbanimeve me origjinë sllave, shqipe, vllahe, turke, toponime të hibridizuara dhe toponime të reja, kryesisht patronime të toponimizuara.

Sot, përveç trajtave të toponimeve të mirëfillta gjuhësore, në Kosovë e ndër të folme shqipe jashtë saj, ndeshim një numër të konsiderueshëm toponimesh kompozitore, të cilat emërtojnë vendbanime fshatrash, qytetesh e trevash. Toponime kompozitore ka me qindra në trevat e ndryshme të Kosovës, e numri i tyre do të ishte sigurisht edhe shumë më i madh sikur të mund të konstatohej etimologjia e shumë toponimeve të tjera, të cilat në shikim të parë nuk hetohen se janë kompozitore.

I veçuam pikërisht këto toponime kompozitore për shqyrtim, sepse paraqesin interes të veçantë nga aspekti i tyre gjuhësor dhe dialektor.\*\*

Disa nga këto toponime na paraqiten me të njëjtën fizionomi gjuhësore e dialektore që nga mesjeta e deri në ditët e sotme, kurse disa sosh kanë evoluar nga aspekti i tyre fonologjik e morfologjik. Mirëpo, përveç toponimeve të hershme kompozitore, të ruajtura që nga mesjeta e deri më sot, ndeshim edhe në toponime që janë formime gjuhësore krejtësisht të reja.

Meqë në të kaluarën historike, në Kosovë, jetuan e sunduan popuj të ndryshëm, qoftë si pushtues, qoftë edhe autoktonë, toponimia e saj na paraqitet me shtresime të larmishme gjuhësore. Prandaj, duke u nisur nga

---

\* Një fragment i këtij punimi u lexua në Konferencën VI të Onomastikës të Jugosllavisë që u mbajt më 9-12 tetor 1985 në Donji Millanovc, kurse u botua në këtë version në revistën *Fjala*, nr. 2 të 15 janarit 1986 me titull: *Mbi evoluimin e disa toponimeve kompozitore mesjetare në të folmet e sotme shqipe*. Ndërsa këtu po e botojmë versionin e përpunuar dhe të zgjeruar, duke sjellë shembuj të rinj.

\*\* Toponimet në gjuhë janë autonome. Ato bartin në vete cilësi dialektore. Prandaj toponimet në radhë të parë janë formime dialektologjike, ndaj studimi dialektologjik i tyre gjithmonë bën pjesë në metodën e studimeve diakronike. Toponimet e marra nga një gjuhë në tjetrën shpesh ruajnë jo vetëm trajtat e vjetra dialektore, por edhe trajtat strukturore të brendshme të gjuhës përkatëse. Etimologjia e toponimit të huazuar shpesh del me etimologji të errët e të pazbërthyeshme. Çelësi i çdo toponimi mund të jetë vetëm gjuha origjinale me mjete leksikore e strukturore të së cilës është sajuar toponimi përkatës.

ky fakt historik, sot ndeshemi me shtresime toponimesh me origjinë: *sllave, shqipe, vllahe, turke, toponime të hibridizuara dhe toponime të reja*, kryesisht *patronime të toponimizuara*.

**1. Toponime kompozitore me origjinë sllave.** — Pjesa dërrmuese e toponimeve të vendbanimeve në Kosovë, shikuar nga aspekti i formimit të tyre gjuhësor, janë me origjinë sllave, por që në të folmet e sotme shqipe, duke iu përshtatur ligjeve fonetike të shqipes, kanë evoluar duke pësuar ndryshime të mëdha. Kështu, pra shumica e toponimeve me origjinë sllave në të folmet serbokroate të shumtën e rasteve ndeshen në forma sintagmatike. Mirëpo, të njëjtat toponime në të folmet e sotme shqipe na shfaqen në trajta kompozitore, ndaj në punimin tonë ne do t'i trajtojmë si të tilla. Kështu, këto toponime në vetëdijen e shqipfolësve, duke lënë anash anën kuptimore të toponimit të caktuar, ato shqiptohen si një tërësi gjuhësore e vetme, që më tepër ka për qëllim orientimin gjeografik se sa aspektin semantik. Madje shpesh nën ndikimin e fuqishëm të theksit se mbi cilën rrokje ose fjalë bie ai, pasojnë edhe shkurtime e shkrirje të elementeve përbërëse të një toponimi, duke mos u hetuar pothuaj fare gjymtyrët kompozitore të tij.

Këtë mendim tonin e dëshmojnë bindshëm shembujt që do të sjellim më poshtë, ku nën ndikimin e theksit të rrokjes disa toponime sintagmatike ose kompozitore janë shkurtuar, rrudhur dhe shkrirë në një tërësi gjuhësore kompakte në ligjërimet e përditshme shqipe, si për shembull: *Sallabâjë*, fshat i trevës së Llapit, i cili është përfutur nga trajta sllave *Kisela Banja; Sarasellë*, që në gojën e shqipfolësit paraqitet si tërësi gjuhësore, duke mos i dhënë rëndësi anës logjike të elementeve përbërëse sintagmatik *Staro selo*, që ka toponimi në gjuhën serbokroate, ose *Staradran* (nga stari dvor+an); *Dobërllukë* (nga Dobra Luka); *Zhilivodë* (nga zli+vode);<sup>1</sup> *Shipol* (nga shestpolja=Shepol=Shipol); *Medërgoc* (nga trajta Milindrugovce),<sup>2</sup> *Muazob* (nga Mihozub);<sup>3</sup> *Begracë* (nga Belogradce=Belograce=Beograce); *Beguncë* (Belo+gunë+ce) që mund të jetë përkthim i trajtës së mëhershme shqipe *gunëbardhi*,<sup>4</sup> e shumë shembuj të tjerë që dëshmojnë për kompozimin e trajtave sintagmatike sllave në kompozita toponimesh ndër të folme të sotme shqipe të Kosovës.

Siç do të shihet edhe nga shembujt e shumtë që do të zëmë ngojë në këtë punim, pjesa dërrmuese e toponimeve sllave janë të përbërë nga sintagmat dygjymtyrëshe.

Sipas kuptimit të regensit të tyre toponimet sintagmatike janë ndarë në disa kategori mbi bazën e të cilave sajohen toponimet në fjalë. Kështu, duke pasur parasysh prejardhjen e formimit të tyre, pjesa më e madhe e toponimeve në gjuhët sllave, formohen me ndajfolje, me attribute ose me

<sup>1</sup> *Oblast Brankovića* (opširni katastarski iz 1455 godine), Sarajevo, 1972, 216.

<sup>2</sup> *Oblast Brankovića*, f. 266.

<sup>3</sup> *Oblast Brankovića*, f. 331.

<sup>4</sup> Svetozar Georgijević, *Etimologija imena mesta SR Srbije*, Sveska VII-VIII, Niš, 1985, f. 34.

emra përcaktues që janë zakonisht pjesë e dytë e toponimit, si: *pod-*, *crna-*, *-sello*, *dobro-*, *-gllava*, *stara-*, *bello-*, *-dol*, *-brdo*, *suho-*, *kollo*, *ravni-*, *zli-zla-*, e mjete të tjera gjuhësore. Pjesa më e madhe e këtyre regjenseve i paraprijnë, duke e përcaktuar pjesën e dytë të toponimit, kurse një pjesë tjetër i ndajshkohet pjesës së parë të toponimit përkatës.

Këtu më poshtë do të marrim në shqyrtim një numër të konsiderueshëm toponimesh nga këto kategori, ashtu si i ndeshim në format e tyre të sotme në të folmet shqipe, por duke u përpjekur që një numër sosh, jo vetëm t'i identifikojmë me format e tyre më të hershme mesjetare, por edhe të saktësojmë pjesët përbërëse të këtyre toponimeve kompozitore.

a) Toponimet kompozitore me origjinë sllave të ndërtuara me ndajfoljen e vendit *pod-*, që i paraprin toponimit, duke dhënë të kuptojmë që një objekt ose vendbanim gjendet nën një tjetër, që gjeografikisht gjendet në një pozitë më poshtë se një tjetër, janë të shpeshta në të gjitha viset e Jugosllavisë, e të këtillë ndeshim mjaft edhe në trevat e Kosovës, si: *Pogragjë*, emër fshati që e ndeshim në komunën e Gjilanit, por edhe në atë të Klinës, që shfaqet nga një trajtë më e hershme *Podgradie*<sup>5</sup> e *Podgrađe*,<sup>6</sup> që hasen edhe në dokumentet e shkruara të mesjetës. Me këtë rrënjë paraqiten edhe emrat e fshatrave *Podgorc* afër Vitisë, e *Podgur* afër Istogut, të cilët në shkrime të hershme i ndeshim me trajtat *Podgorzi*<sup>7</sup> dhe *Podgori*.<sup>8</sup> *Podrime* (nga Pod+Drim+lje=Podrimlje) si trevë që përfshin disa qytete e një numër të madh fshatrash. Këtë trevë ndër relatorët shqiptarë e ndeshim edhe si *Tejdrinia*, ku për bosht semantik është marrë lumi *Drin*, krahaso edhe me emrin *Zadrimë-a* e *Zagorë*, fshat në rrethin e Vuçitërnës e *Zabërgja*, në Shalë të Bajgorës. Ndonëse emri i fshatit *Polluzhë* në shikim të parë sot na duket si toponim njëgjymtyrësh i mirëfilltë, ai në dy regjistrimet e trevës së Brankoviqve është i shënuar me trajtat *Podluža* e *Podlužje*.<sup>9</sup> Nuk ka dyshim se edhe emri i fshatit *Pobërgjë* vjen nga trajtat *podbrdie*=*podbrde*, duke përfunduar në trajtën e sotme *Pobërgjë*, ku grupi konsonantik *dj* edhe në të folmet shqipe është përfutur në *gj* (shih E. Çabej).<sup>10</sup>

<sup>5</sup> Ahmet Kasumović, *O toponimima s prijedlogom pod-u u Tuzlanskom govoru*, Vtora Jugoslavenska Onomastička Konferencija (Skopje 6-9 oktombri 1977), Skopje, 1980, f. 149.

<sup>6</sup> *Oblast Brankovića*, f. 328.

<sup>7</sup> Mihailo Dinić, *Iz Dubrovačkog Arhiva*, Beograd, 1957, f. 38, 39.

<sup>8</sup> M. Dinić, *po aty*, f. 38.

<sup>9</sup> *Oblast Brankovića*, f. 43.

<sup>10</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1976, f. 130 (fjala *dora* e përdorur me kuptimin „e shkreta, e gjora”, del së pari te Hahni II, 30, i cili shënon: „sh. diegurë”. Edhe Pedersen 118 se fjala duket si një particip i moçëm i *djeg* me rënie të g-së inervokaliqe; të dy dijetarët kanë parasysh greqishten e re  $\eta\kappa\upsilon\mu\epsilon\upsilon\eta$  „mjera” prej  $\kappa\alpha\tau\omega$  „djeg”. E ka si i *djorë* edhe Kristoforidhi. Me të drejtë A. Xhuvani *djorë* e *gjorë* e lidh te *djerr*. Ky afrim vërtetohet tani me formën e *djerra* „e shkreta, e mjera, djora”). Siç shihet nga këta shembuj shkrirja e togut *dj* në *gj* në shqipe është fenomen i hershëm i saj, e këtë e dëshmojnë edhe më mirë të folmet dialektore (Shih të folmen e Moravës së Epërme).

b) Ndërkaq një numër toponimesh të kësaj natyre formohen nga një mbiemër sllav *črvena, črna, čirna, cerna, crno*, i cili në të folmet shqipe, nën ndikimin e asimilimit progresiv *rn*, u reflektua në sonantën *rr* të fortë, që sipas Eqrem Çabejt është një fenomen i brendshëm i shqipes. Prandaj, duke iu nënshtruar këtij fenomeni fonetik, ndër të folmet e sotme shqipe ndeshim emrat e vendbanimeve me këto trajta: *Carrabreg* (në serbokroat. Cernobreg), kurse në mesjetë, në krisovulat e Deçanit na del me trajtën *Črveni breg*.<sup>11</sup>

Ndërkaq, në Defterin e regjistrimit të Sanxhakat të Shkodrës, të vitit 1485 e ndeshim me trajtën *Çirun brek*,<sup>12</sup> e M. Milojeviqi e shënon edhe si *Crveno Brežanin*.<sup>13</sup>

Në tipin e emrave të vendbanimeve të zëna ngojë bëjnë pjesë edhe emrat e fshatrave: *Carrallukë*, që në serbokroatishte e ndeshim me formën *Crnaluka*, kurse në shkrime na del me trajtat *Çirna Luka* e *Çirnalug*,<sup>14</sup> *Carravranë* e që forma e hershme e këtij vendbanimi del me trajtën *Cerna Vrana*; *Carralevë* (në serb. Crnojlevo) që në mesjetë e ndeshim me trajtat *Crnjalovo* dhe *Gornje Crnojlevo*;<sup>15</sup> *Carraticë* fshat në Luginën e Moravicës në komunën e Preshevës, që në serbokroatishte sot përdoret trajta *Crnotince* siç e ndeshim edhe trajtën *Cerrcë*, fshat në anën e Istogut, të cilën në serbokroatishte e ndeshim me trajtën *Crnce*. Po kështu edhe toponimet *Cërrrik* (nga Cernik) dhe *Çorrovodë* (nga Černa voda), etj. (khs. *çarranik* në vend të *çerenik* sllav. *čeren*, E. Çabej, Stud. gjuhësore, 154), por ndeshim edhe përjashtime siç e dëshmon emri i vendbanimit *Cernicë*, fshat në Moravën e Epërme, e ndonjë tjetër.

Meqë këtu kemi të bëjmë me fenomenin e asimilimit të togut konsonantik *rn* në *rr*, këtu bënë pjesë edhe emri i qytetit *Vuçitërnë*, që ndër të folme dialektore na del me trajtat *Vuçitërr*, *Vushtërr* e *Vushtrrri*, kurse ndër dokumente mesjetare e ndeshim me trajtën *Vlčiji trn*<sup>16</sup> dhe *Vlčitrn*<sup>17</sup> dhe *Orrobërdë* nga *Orna brda*, fshat i komunës së Istogut.

c) Një numër i konsideruar fshatrash të Kosovës, madje dhe jashtë saj ku flitet shqipja, kanë si pjesë përbërëse të kompozitës emrin *-sello*: *Novosellë*, *Starasellë* e *Sarasellë*, që janë mjaft të përhapur në shumë treva ku flitet shqipja. Lidhur me këta emra mund të përmendim se para se të emërtoheshin këto fshatra në trevën e nahijes së Topolnicës e të Moravës, ekzistonin dy vendbanime më të hershme me emrin *katun* (chatun). Njëri në jugperëndim të Vranjës, ku sot e ndeshim emrin *Novosellë*, si antipod i emrit të vjetër *katun* dhe tjetri në perëndim të Ferizajt me emrin *Starasellë*<sup>18</sup>

<sup>11</sup> Milica Grković, *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, f. 154.

<sup>12</sup> Selami Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakat të Shkodrës*, Tiranë, 1974, f. 321.

<sup>13</sup> M. Milojević, *Dečanska Hrisovulja*, f. 4.

<sup>14</sup> Selami Pulaha, *po aty*, f. 246.

<sup>15</sup> Oblast Brankovića, f. 179.

<sup>16</sup> Gavro Škrivanić, *Geografskih naziva Srednjovekovne Zete*, Titograd, 1959, f. 49.

<sup>17</sup> Oblast Brankovića, f. 29.

<sup>18</sup> Oblast Brankovića, f. 203.

si dëshmi dhe përforsim i një vendbanimi të vjetër, mbi truallin e të cilit vazhdon jeta e fshatarëve të këtij vendbanimi të lashtë. Emërtimi i vendbanimeve me emrin *katun* në mesjetë ishte më i shpeshtë, me këtë formë ndeshim *Blgarski katun*<sup>19</sup> për fshatin *Bugariqi* i sotëm.

Të këtij tipi janë edhe emërtimet e vendbanimeve *Gumnasellë* (nga Guvno sello), *Gllanasellë* (nga Gladna selo), që siç shihet pra, në gjuhën serbokroate i ndeshim në trajta sintagmatike, kurse në shqipe janë ngjizur në trajta kompozitore. Po kështu edhe emri i fshatit *Pustasellë*, si në dialektin e serbishtes së Kosovës, ashtu edhe në Krisovulat e Deçanit e ndeshim me trajtë sintagmatike *Pusto selo*,<sup>20</sup> *Petrovasellë* (Petrovo selo), *Llapsesellë* dhe *Llapnasellë*, që e ndeshim në të folme shqipe, që në mesjetë del me trajtën *selo Hlaplje*,<sup>21</sup> ku me ndërrimin e rendit sintagmatik u përfatuan format e zëna ngjoje në shqipen e sotme.

ç) Toponime kompozitore që cilësohen me gjymtyrën atributive të sllavishtes *dobro-*: *Dobërllukë*, që me 1477 dhe më 1478 na del si toponim njëgjymtyrësh *Luka*,<sup>22</sup> që me gjasë duhet të jetë *Dobërlluka* e sotme e Vuçitërnës. Kështu në mesjetë në trevën e Llapit më 1477 dhe më 1478 permendet një fshat me emrin *Šumna Luka* dhe *Šamaluk*,<sup>23</sup> që gjendej në lindje të Podujevës që jep mundësi të mendohet për fshatin *Lluga* e sotme, ku me sonorizimin e *k-së* në *g* është përftuar forma e sotme.

Emrin e fshatit *Dobërdub* e *Dobridub*, që e ndeshim sot, i cili në mesjetë ndeshet me trajtën sintagmatike *Dobro Dubko*,<sup>24</sup> që gjendej në perëndim të Prishtinës. Emra të këtij tipi ndeshim mjaft anembanë Kosovës, si: *Dobërdolan* (Suharekë), *Dobrosin* (Bujanovc), *Dobërçan* (Gjilan), *Dobrosellë* (Prishtinë), etj.

Trajta e fshatit *Dobërçan*, që gjendet në anën e Moravës, në dokumentet mesjetare ndeshet me trajtën morfologjike *Dobroselani* dhe *Dobruzane*,<sup>25</sup> mbase kemi të bëjë me *Dobërçanin* e sotëm.

d) Nuk është rast i rrallë që një numër fshatrash të emërtohen me trajta sintagmatike, të cilat si pjesë të dytë të saj kanë emrin- *gllava*; kurse në dialektet e shqipes reflektohen si toponime kompozitore, si për shembull: *Komogllavë*, përballë trajtës *Kemenogllava* të serbishtes; *Drenogllavë*, që në mesjetë del po me këtë emër *Drinoua Glaua*,<sup>26</sup> kurse në dokumentet turke del me trajtat *Dirna glava* e *Dernagllava*. *Velegllavë*, fshat që gjendet në lartësinë më të madhe të maleve të Gollakut të Kamenicës. Trajtën e hershme të këtij vendbanimi e ndeshim në formën *Velia Glaua*.<sup>27</sup> Mirëpo kur kemi parasysh pozitën e saj malore e kodrinore,

<sup>19</sup> Latif Mulaku, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, Priština, 1968, f. 19.

<sup>20</sup> M. Grković, *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, f. 154.

<sup>21</sup> *Oblast Brankovića*, f. 216.

<sup>22</sup> *Oblast Brankovića*, f. 150.

<sup>23</sup> *Oblast Brankovića*, f. 320.

<sup>24</sup> *Oblast Brankovića*, f. 219.

<sup>25</sup> M. Dinić, *Iz Dubrovačkog Arhiva*, f. 77.

<sup>26</sup> M. Dinić, *po aty*, f. 77, 98, 111.

<sup>27</sup> M. Dinić, *po aty*, f. 88.

ku edhe sot ndeshim toponimin *Kodra Madhe*, ekziston mundësia që trajtat e sotme të jenë të kalkuara prej saj. Toponime të kësaj kategorie me gjymtyrën e dytë *-gllava*, janë edhe këto *Kobillagllavë*, *Lutogllavë*. Ndërkaq fshati i dikurshëm me emrin *Lipoglava* e *Lepoglava*<sup>28</sup> sot nuk ekziston.

dh) Një kategori emërtimeve të vendbanimeve të sajuara nga kompozitat, përbëjnë toponimet, të cilat si gjymtyrë të parë kanë emrin sllav *stara*, siç kemi zënë ngojë toponimet *Starasellë*,<sup>29</sup> *Stantërk*<sup>30</sup> nga trajta serbokroate *Stari trg*, *Staradran*, fshat në anë të Istogut, që është përfutur nga trajta sintagmatike e sllavishtes *Stari dvor*, ku duke marrë prapashtesën *-an*: *Stari + dvor + an*, në të folmen shqipe nën ndikimin e fuqishëm të theksit, që ra në rrokjen e parë dhe të fundit *stárad (vo) rán*, rezultoi trajta e shqipes *Staradran*.

e) Një kategori toponimesh të vendbanimeve i ndeshim me mbiemrin *bello-*, që përdoret si gjymtyrë e parë e toponimit si, për shembull, *Bellacerkë*, që gjendet në mes të Gjakovës e Prizrenit, e cila në dokumentet e hershme mesjetare del në trajtat sintagmatike *Bela Crkva* (Бела Црква),<sup>31</sup> që në këtë tip bëjnë pjesë edhe toponimet *Bellobrad*, *Begracë*, që në serbokroatishte shqiptohet *Bellogra(d)ce* e *Beguncë*, nga *Bellogunce* (S. Georgijeviq, Etimologija imena mesta SR Srbije 34). Këtu mund të përmendim edhe toponimin *Bellopojë* (nga trajta e parme sintagmatike e sllavishtes *Belo+polje*), që është mjaft frekuentuese, sepse ndeshet në disa komuna të Kosovës, si në Podujevë, Istog, në Pejë e gjetiu. Këtë toponim e ndeshim edhe në dokumentet mesjetare, në Kadastrin e 1455 të Oblast Brankoviçe<sup>32</sup> dhe në Krisovulat e Deçanit me trajtën *Belo Polje*, ku *l*-ja sllave në përputhje me ligjet fonetike të shqipes u reflektua në *j*, siç e dëshmon edhe toponimi *Tropojë*, që në dokumente e ndeshim si *Trebopole* (ТрБ Бополе)<sup>33</sup> dhe *Trejpolja*<sup>34</sup> që haset në Kadastrin e Shkodrës. Alternimin e *l*-së sllave në *j*-në e ligjërimeve shqipe e dëshmojnë edhe këta shembuj: *Opojë* (nga *Opolja*), *Crmjan* (nga *Crmljane*), *Ramjan* (Ramljane), *Lipjan* (Liplane), *Llabjan* (Labljane), *Ramidejë* (Ravidel, emër mali në fshatin Cernicë), etj.

ë) Janë të shpeshta edhe toponimet që në pjesën e dytë të tyre përmbajnë emrin *-dol*, siç janë emrat e vendbanimeve: *Dobërdol*,<sup>35</sup> *Teneshdoll*,<sup>36</sup> *Suhadoll*,<sup>37</sup> *Vranidoll*, (shih edhe Arbanaški Do, në juglindje të Cetinës, Onomastika e Kosovës, 178, etj. Ndërkaq, një numër toponimesh të këtij tipi që dikur në mesjetë ekzistonin, tani nuk ekzistojnë

<sup>28</sup> Oblast Brankovića, f. 207.

<sup>29</sup> Oblast Brankovića, f. 203.

<sup>30</sup> L. M u l a k u, *Govor Albanaca Bajgorske Šalje*, Priština, 1968, f. 12.

<sup>31</sup> M. G r k o v i ć, *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, f. 144.

<sup>32</sup> M. G r k o v i ć, *po aty*, f. 144.

<sup>33</sup> Oblast Brankovića, f. 44.

<sup>34</sup> S. P u l a h a, *po aty*, f. 187.

<sup>35</sup> Oblast Brankovića, f. 25.

<sup>36</sup> Oblast Brankovića, f. 283.

<sup>37</sup> Oblast Brankovića, f. 220.

më siç janë: *Gladni dol*<sup>38</sup>, *Kozdol*,<sup>39</sup> *Çepindol*.<sup>40</sup> Këto toponime ose janë zhdukur ose kanë marrë emra të tjerë, siç ndodhi me toponimin *Sfinodol*<sup>41</sup>, (Svinjari i sotëm në Mitrovicën e Titos), që na shpie të mednojmë për një formë shumë më të hershme shqipe *Kryethi*, që mund të jetë kalkuar në trajtën e mëvonëshme mesjetare nëpërmjet Svinogllav në *Sfinodol*, prej nga sot kemi trajtën toponimike njëgjymtyrëshe *Svinjari*, ose edhe toponimi *Zubin dol*,<sup>42</sup> që mund të jetë *Zubin Potoku* i sotëm.

f) Gjithashtu ndeshim toponime të shpeshta me pjesën e dytë të kompozitës me emrin *-brdo*: *Novobërdë*, të cilën në mesjetë e ndeshim edhe si *Nuova Monte*,<sup>43</sup> kurse te relatorët shqiptarë e ndeshim shpesh edhe trajtën shqipe të kalkuar *Mali i Ri*<sup>44</sup>, *Bellobërdë*, *Gollobërdë*, *Pobërgjë* (nga podbrdje), *Zabërgjë* (*Zabrdje*), etj.

g) Edhe me atributin *suho-* si pjesë cilsuese e pjesës së dytë ndeshim një mori emrash të vendbanimeve të sotme në Kosovë, si: *Suharekë*,<sup>45</sup> *Suhagërl*,<sup>46</sup> *Suhadoll*,<sup>47</sup> etj. Këtu vlen të përmendim se format e këtyre toponimeve me ndajfoljen atributive *suho*, të cilat i ruan sot shqipja janë forma të kryehershme të sllavishtes së vjetër, të cilat ende nuk kishin kaluar *h*-në në *v*, por e ruajtën deri në fund të shekullit XVIII, kurse pas shekullit XVIII në gjuhën serbokroate i ndeshim me interdentalen *v*, si: *Suwareka*, *Suvidoll*, etj.

gj) Një kategori emrash të përbërë prej kompozitash toponimike në Kosovë i ndeshim me pjesën e dytë të saj *-kollo* (*chollo*), që ka kuptimin e minierës, të galerisë, aty ku dikur nxirrej ndonjëfarë xehe. Të tilla ka pasur mjaft në trevat e Kosovës, por edhe sot kanë mbetur gjurmët e tyre ndër emërtime toponimike, kurse në disa raste edhe janë thjeshtuar, duke rënë pjesa e dytë *-kollo* me pasivizimin e xeherores. Të këtilla toponime kompozitore pandehen: *Vërnakollë* (nga Vrano *chollo*), lagje e dikurshme e fshatit të sotëm *Shashare* (*Cholo Sesaraouich*),<sup>48</sup> që gjendet në shpatijet e Karadakut të Vitisë, afër Letnicës; *Nizhnakollë*, sot lagje e fshatit më të madh të Gollakut të Prishtinës, Marecit, e cila në mesjetë ndeshet me trajtën *Nixchino chollo*;<sup>49</sup> *Rekekollë*, gjithashtu gjendet në fshatin Marec, që kishte trajtën e hershme *Raichau chollo*,<sup>50</sup> *Keçekollë*, fshat i Gollakut që në serbokroatishte përdoret me trajtën *Kačikol*; *Kolloleç*, fshat në Moravën e

<sup>38</sup> *Oblast Brankovića*, f. 207.

<sup>39</sup> *Oblast Brankovića*, f. 112.

<sup>40</sup> *Oblast Brankovića*, f. 59.

<sup>41</sup> *Oblast Brankovića*, f. 36.

<sup>42</sup> *Oblast Brankovića*, f. 12.

<sup>43</sup> M. D i n i ć, *po aty*, f. 27, 55.

<sup>44</sup> I n j a c Z a m p u t i, *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme në shekullin XVII*, vëll. I (1610-1643), Tiranë, 1963, f. 341.

<sup>45</sup> *Relacione* vëll. II, f. 256.

<sup>46</sup> S. P u l a h a, *po aty*, f. 198.

<sup>47</sup> *Oblast Brankovića*, f. 22.

<sup>48</sup> M. D i n i ć, *po aty*, f. 74.

<sup>49</sup> M. D i n i ć, *po aty*, f. 81.

<sup>50</sup> M. D i n i ć, *po aty*, f. 76, 79.

Poshtme, që bën pjesë nën administratën e komunës së Kamenicës, në mesjetë shfaqet me trajtat *Kololoçnik*<sup>51</sup> dhe *Kololuçniç*.<sup>52</sup> Ndërsa toponimi *Hainouo chollo*,<sup>53</sup> që emëronte Hajnovcin e sotëm të komunës së Kamenicës, i cili përmendet në vitin 1438, sot nuk ka trajtën e toponimit sintagmatik ose kompozitor, por ndeshet në përdorim të së folmes së përditshme si toponim i mirëfilltë njëgjymtyrësh.

h) Ndërkaq, disa emrave toponimikë i paraprin ndajfolja e mënyrës në gjuhën serbokroate *ravni*, ku grupi konsonantik *vn* i sllavishtes në gjuhën shqipe kaloi nëpër tri faza, si  $vn=mn=m$ . Këtë e dëshmojnë toponimet në fjalë: *Ramabâjë* (nga Ravna Banja), *Ramidejë* (nga Ravnidel, parcelë mali, pronë e fshatit Cernicë të Moravës së Epërme), *Ramacerë* (Ravni cer), etj. (Shih më gjerësisht për këtë fenomen te Latif Mulaku).<sup>54</sup>

Mirëpo, përveç dukurisë në fjalë, ndeshim edhe raste përjashtuese, ku *vn* sllave, nuk kaloi nëpër këto tri faza, por u reflektua drejt në *n*, siç e dëshmojnë shembujt: *Ranilluk* (Ravni lug), fshat buzë Moravës që administrativisht sot bën pjesë në komunën e Kamenicës dhe *Randobrava* (nga Ravno Dubrava), e ndonjë tjetër.

i) Disa toponime me origjinë sllave i ndeshim me ndajfoljen *zli-zla*, si: *Zlivode*,<sup>55</sup> që u përftua në *Zelivode*, kurse sot ndër të folme shqipe ndeshim trajtën *Zhilivodë*, fshat në komunën e Vuçitërnës, *Zlipotok* (Dragash), *Zlakuçan*, etj.

j) Toponime me mjete leksikore sllave pendehen edhe këta emra vendbanimesh: *Velikorekë*, *Kizharekë* (trajta serbokroate Kishnareka), *Kishnapolë*, *Prekollukë*, *Paldonicë* (trajta serbokroate Palivodenica), *Muaozob*, trajta e hershme mesjetare ndeshet *Mihozub*,<sup>56</sup> *Zubinpotok*, dikur *Zubin Dol*,<sup>57</sup> *Ostrozub*, *Ostrogllav*, *Sallabajë* (nga trajta e plotë Kisela Banja), *Babimovc* (serb. Babin Most), *Doblibare*, *Brosanë* (trajta e mirëfilltë Brodosanë, ndërsa në të folmet serbokroate *Brodosavac*), *Mirosalë* (në serbokroatishte Mirosavlje) *Medërgoc* (nga Milindrugovce),<sup>58</sup> *Muçibabë*, *Muçivërc*, etj.

Nga e gjithë kjo që shtjelluam deri më tani dëshmon se pjesën dërmuese të toponimeve kompozitore të formuara me mjete leksikore sllave për herë të parë i ndeshim ndër dokumente kishtarë mesjetare sllave të administratës së shteteve mesjetare feudale të perandorëve serbë. Edhe pse pjesa dërmuese e toponimeve në fjalë nga aspekti gjuhësor janë sajuar me mjete leksikore sllave, megjithatë nga aspekti i tyre morfologjik, sintaksor dhe etimologjik hetohen përshtatje të pjesërishme ose përkthime

<sup>51</sup> *Oblast Brankovića*, f. 205.

<sup>52</sup> S. R i z a j, *Disa të dhëna antroponimike e toponimike në shekujt XIV-XV në dritën e burimeve osmane*, „Onomastika e Kosovës” (25-27 shkurt 1977), Prishtinë, 1979, f. 167.

<sup>53</sup> M. D i n i ć, *po aty*, f. 88.

<sup>54</sup> L. M u l a k u, *Gjurmime albanologjike*, nr. 2, 1965, f. 323-326.

<sup>55</sup> *Oblast Brankovića*, f. 21.

<sup>56</sup> *Oblast Brankovića*, f. 328.

<sup>57</sup> *Oblast Brankovića*, f. 12.

<sup>58</sup> *Oblast Brankovića*, f. 266.

të fjalëpërfjalëshme nga shqipja në serbokroatishte si për shembull *Mali i Zi Crna Gora*, që u krijua si i tillë pas ardhjes së sllavëve me përkthim, duke u zgjidhur pastaj përmes emërtimit turk *Karadag* (Karadak), sepse kjo ishte rruga më e lehtë për ta kapërcyer ngarkesën socio-kulturore dhe për ta evituar trisinë. Kështu ndodhi në kohën e sundimit turk kur turqishtja u bë gjuhë e administratës dhe e kulturës, si në rrethin e Shkupit, ku u ruajt termi *Karadak*,<sup>59</sup> e nuk u përdorën as emërtimi *Mali i Zi*, e as *Crna Gora*. Unë mendoj se një përkthim i këtillë mund të ketë ndodhur edhe me emërtimin *Beguncë*, nga *Belloguncë*, e kjo siç dëshmon emri i fshtatit *Gunesi* (nga *gunë*)<sup>60</sup> emërtim zejeje ose veçori fiziko-etnografike *Gunëbardhi* khs. me *Gurikuqi* më 1416, sllav. „Crveni kamen” e romanisht „Piera Rossa”,<sup>61</sup> *Kroni Bardhë*, që te B. Nushiqi e ndeshim në përkthim *Bele vode*,<sup>62</sup> *Mali i Bardhë* dhe *Bijela Gora*, që sot në Ulqin bashkëjetojnë si dubletë, por që s’do mend se kemi të bëjmë me një kalk.<sup>63</sup> Po kështu *Bjeloglavci* në fushën e Zetës.<sup>64</sup> që përmendet më 1348, kurse në kartën e vitit 1355 të Car Dushanit ku përmenden pronat e manastirit të Shën Nikollës së Dobrushtës përmendet edhe *Gin Beli*,<sup>65</sup> që është një përkthim i fjalëpërfjalshëm i *Gjin Bardhit*. Kështu te emërtimi *Bellogun* kemi një emërtim të tipit *Belloglavci* (Клтохиъ Ђлоглавци)<sup>66</sup> e *Bellobrad* që përmendet në anë të Opojës, emërtim në bazë të veshjes e vetive fizike (khs. *Flokovci* të anës së Prizrenit). Analog me këta shembuj mund të supozohet se edhe për emërtimin *Zhilivodë* (nga *zli+ vode*) mund të kemi të bëjë me një kalkim nga trajta *Kroni keq*, (shih te Çabeji top. Ujzi, Stud. Gjuhësore II, f. 239), analog me *Zli Kami* nga *Guri keq*<sup>67</sup>, ose me shembujt *Lugu i keq*, *Prroni keq* me trajtën *keqpotok*<sup>68</sup> dhe *Prroni i Morinës* me *Potok Morina*, *Kryeglav*, *Arat e Zallinës* kalkuar në emërtimin *Njive peskuša*,<sup>69</sup> etj. Këto mikrotoponime dëshmojnë se përshtatje e përkthime mund të kenë ndodhur edhe në emërtimet e vendbanimeve të ndryshme të Kosovës dhe të viseve të tjera nga gjuha shqipe në atë serbokroate. Një

<sup>59</sup> R e x h e p I s m a j l i, *Disa çështje të onomastikës mesjetare*, „Onomastika e Kosovës” (simpoziumi më 25-27 shkurt 1977), Prishtinë, 1979, f. 49.

<sup>60</sup> M i l l a n S h u f f l a y, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 47.

<sup>61</sup> M. S h u f f l a y, *po aty*, f. 213 (shih edhe te L j u b i ć, *Starine*, f. 14, 54 e *Listine* f. 110, 539).

<sup>62</sup> S h e f q e t P l l a n a, *Toponimet shqipe të Kosovës në veprën e B. Nushiqi*, „Onomastika e Kosovës”, f. 420 (Kroni Bardhë te Nushiqi Kronj te bal dhe në përkthim Belevode, Kroni Despotit (Despotov Studenac).

<sup>63</sup> R u z h d i U s h a k u, *Ulqini dhe rrethina në dritën e disa makro e mikrotoponimeve*, „Onomastika e Kosovës”, f. 19.

<sup>64</sup> M. S h y f f l a y, *po aty*, f. 150 (Bjeloglavcët në fushën e Zetës që përmenden në vitin 1348).

<sup>65</sup> S. N o v a k o v i ć, *Zakonski spomenici srpskih država srednjega veka*, Beograd, 1912, f. 423.

<sup>66</sup> S. N o v a k o v i ć, *po aty*, f. 688 (клтохиъ Ђлоглавци në atë të Prizrenit).

<sup>67</sup> S k ë n d e r G a s h i, *Prania e etnosit shqiptar në Kosovë gjatë shekujve XIII-XIV në dritën e burimeve kishtarë serbe*, „Onomastika e Kosovës”, f. 85.

<sup>68</sup> T e f i k M o r i n a, *Disa të dhëna mbi evidentimin e mikrotoponimeve të Kosovës*, „Onomastika e Kosovës”, Prishtinë, 1979, f. 215.

<sup>69</sup> T. M o r i n a, *po aty*, f. 214.

proces i këtillë u krye nën ndikimin e forcimit të administratës kishtare mesjetare, atëherë kur lindi edhe nevoja e unifikimit të administratës shtetërore, që ishte qëllimi i kishës që të kuptohen dhe të përkthehen të gjitha emërtimet që kishin etimologji të zbërthyeshme. Kjo mund të jetë një nga arsyet që në mesjetë ndeshemi, përveç tipave të tjerë të toponimeve, edhe me tipin e toponimeve kompozitore.

**2. Toponimet kompozitore me origjinë shqipe.** — Ndërkaq një numër emrash të vendbanimeve, të fshatrave ose të trevave të ndryshme na dalin me origjinë shqipe, që shumica e tyre ndeshen edhe në dokumentet e shkruara mesjetare, disa me trajta të sotme, kurse një pjesë e tyre kanë pësuar evoluime fonetike a morfologjike. Në këtë punim tonin do të marrim në shqyrtim disa nga toponimet ekzistuese të këtij tipi, por me këtë rast nuk do të lëmë pa përmendur edhe ndonjë vendbanim të zhdukur të tipit të toponimeve kompozitore në fjalë. Shikuar nga mënyra e formimit të këtyre toponimeve kompozitore, nga njëra anë, dhe nga numri jo i vogël i toponimeve të këtij tipi, qoftë ekzistuese, qoftë edhe të atyre të zhdukura, nga ana tjetër, që do të marrim në shqyrtim këtu, ndeshemi kryesisht me tre tipa toponimesh të përbërë prej *emër + emër*, *emër + mbiemër* dhe *parafjalë + emër*, e ndonjë tip tjetër, siç është ai i patronimeve të toponimizuara që ndeshet mjaft shpesh, por për të cilin do të bëjmë fjalë në një pikë të veçantë të këtij punimi.

a) Tipi i toponimeve kompozitore *emër + emër* në krahasim me atë të tipit *emër + mbiemër*, është më i kufizuar, por megjithatë e ndeshim mjaft në treva të ndryshme ku flitet sot shqipja. Këtu kemi të bëjmë me dy emra të kompozuar, që së bashku në mënyrë më të plotë, përcaktojnë anën, pozitën ose cilësinë e një toponimi përkatës. Këtë tip toponimesh në trevën e Kosovës e ndeshim më rrallë, ndërsa në treva të tjera ndeshet më shpesh. Këtu sot në Kosovë ndeshim toponimin *Fushë-Kosovë*, përballë të cilit përdoret edhe dubleti *Kosovo-Polje* në gjuhën serbokroate. Si duket ky toponim kompozitor është formuar rishtas, por analog me toponimet më të hershme në të folmet shqipe siç janë: *Fushë-Krujë*, *Fusharzë*, etj.

Në fshatin Arbënesh të Krajës ndeshim mikrotoponimet *Fushubla* e *Fundubla*, që sjell I. Dodaj.<sup>70</sup> Ndërsa për etimologjinë e mërtimit të parrmë *ubla* bëjnë fjalë shterueshëm E. Çabej<sup>71</sup> dhe I. Ajeti,<sup>72</sup> të cilët kanë mendime të kundërta njëri me tjetrin.

Kohëve të fundit, në mjetet tona të informimit, në analogji me tipin e toponimit kompozitor *Anamali*<sup>73</sup> (të përbërë nga *an + mal*), krahinë e Malit të Zi e banuar me popullsi shqiptare, po qet krye përdorimi i shpeshtë

<sup>70</sup> I s m a j l D o d a, *Rreth identifikimit të disa toponimeve të Krajës*, „Onomastika e Kosovës” (Simpoziumi 25-27 shkurt 1977), Prishtinë, 1979, f. 177.

<sup>71</sup> E. Ç a b e j,

<sup>72</sup> I. A j e t i, *Studij iz istorije albanskog jezika*, Priština, 1982, f. 196.

<sup>73</sup> R u z h d i U s h a k u, *Ulqini dhe rrethina në dritën e disa makro e mikrotoponimeve*, „Onomastika e Kosovës”, f. 23.

i toponimit *Anamoravë-a*, që sipas mendimit tim gjuhësisht është i drejtë, ndërsa kuptimisht i arsyeshëm dhe i natyrshëm.

Kjo krahinë përfshin një makroregjion të përbërë nga mikroregjionet e Moravës së Epërme, Moravës së Poshtme dhe fshatrave rrëzë maleve të Zhegovcit, maleve të Karadakut dhe atyre të Gollakut. Prandaj, me toponimin *Anamoravë* (anë + Moravë), që do të thotë trevat e Luginës së Moravës, që në serbokroatishte emërtohet *Pomoravlje*.

Në regjistrin e Kadastrit të Shkodrës të viteve 1416-1417 ndeshim toponimet kompozitore të tipit *emër + emër Bishtrrjolla*<sup>74</sup> dhe *Balldrini* me trajtat *Baladrini* e *Balldrëni*<sup>75</sup> (nga ballë + Drini), fshat në afërsi të Lezhës, që sipas E. Çabejt në veri nuk përmban kuptimin e elementit *ball* „mal”, po në pajtim me pozitat e atij vendi do të thotë përballë Drinit<sup>76</sup> ose buzë Drinit, në breg të Drinit, siç e ndeshim *Bregbunë* e *bregabunas*.

Ndërkaq, toponimi *Kryethi*, që në Kadastrin e Shkodrës ndeshet edhe si *Krueti*, i përbërë prej dygjymtyrësh kategorish emërore *krye + thi*, fshat i paidentifikuar, që gjendej ndërmjet Gajtënit e Sheldisë e pranë Kuklit.<sup>77</sup> Ky toponim ndeshet dendur edhe ndër patronime mesjetare, që figurojnë si borxhlinj në regjistrin e kadastrit të Shkodrës siç janë *Zorzi Krueti* (Kryethi),<sup>78</sup> *Pjetër Krueti* (Kryeti, Kryethi),<sup>79</sup> që si duket më vonë ndër dokumente kishtarë serbe të mesjetës po këtë antroponim e ndeshim në trajtë të kalkuar *Svinoglav*.<sup>80</sup>

Toponime kompozitore, veçanërisht mikrotoponime me gjymtyrën e parme përcaktuese *qafë*, ndeshim mjaft shpesh ndër të folme shqipe të trevave të ndryshme, siç e dëshmojnë këta shembuj: *Çafduhle*, *Çafa Prushit*, *Çafa Morinës*, *Qafëkrrabë*, *Qafthanë*,<sup>81</sup> *Çafebuellit*, *Qafëgratë*, lagje e Reçit të Poshtëm<sup>82</sup> dhe *Qafë-shakull*, që gjendet në Rranxa të Bushatit,<sup>83</sup> etj. Të këtij tipi janë edhe toponimet *Bregbunë*<sup>84</sup>, fshat që përmendet më 1417 dhe toponimi *Bregdeti*, lagje e fshatit Velipojë<sup>85</sup>. Me interes të veçantë është të përmenden edhe trajtat evolutive të fshatit *Symizë*, që në

<sup>74</sup> *Regjistri i Kadastrit dhe i koncesioneve për rrethin e Shkodrës 1416-1417*, Tiranë, 1977, f. 47.

<sup>75</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 101.

<sup>76</sup> E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1976, f. 53 (shih edhe te *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore dhe të Mesme shekulli XVII*, vëll. I (1610-1634), Tiranë, 1963, f. 502.

<sup>77</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 229.

<sup>78</sup> *Vep. e cit.* f. 79.

<sup>79</sup> *Vep. cit.* f. 104.

<sup>80</sup> R e x h e p I s m a j l i, *Disa çështje të onomastikës shqiptare*, „Onomastika e Kosovës”, f. 53 (cituar nga botimi i P a v l e I v i ć, i M i l i c a G r k o v i ć, *Dečanske hrisovulje*, Novi Sad 1976, f. 17, ku thuhet: „Današnjem čitaocu mnoga od tih imena zvuče neobično”).

<sup>81</sup> Q e m a l M u r a t i, *Apelativat toponimik në toponiminë e Kërçovës*, „Onomastika e Kosovës”, f. 348.

<sup>82</sup> K o l ë L u k a, *Gjeografia toponomastike në dy Kadastrat e Shkodrës të shekullit XV*, „*Studime filologjike*”, nr. 2, 1976, f. 142.

<sup>83</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 150.

<sup>84</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 130.

<sup>85</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 149.

periudhën mesjetare në dy kadastrat e Shkodrës na del me trajtat *Somesi* e *Sumesi*, që më 1417 kishte 19 zjarre, kurse me 1485 e ndeshim si fshat të braktisur, por që vendosja e re bëhet në fshatin *Sumëzi* ose *Zumëzi*,<sup>86</sup> që gjendet në rranza të Mbishkodrës, që më vonë bën pjesë në Bushat si edhe sot, por ky toponim sot nuk ka trajtën kompozitore.

b) *Toponimet kompozitore të tipit emër + mbiemër* me origjinë shqipe janë mjaft të shpeshta në treva të ndryshme me popullsi shqiptare. Pjesën dërmuese të tyre i ndeshim edhe në dokumente të shkruara mesjetare, që disa sosh janë zhdukur, kurse një numër i tyre ekzistojnë edhe sot.

Në këtë tip bëjnë pjesë emrat: *Ujmir*, *Buzez*, *Buzigatani*, *Buzujë*, *Palabardh*, *Lumbardh*, *Gruemirë*, *Bukëmirë*, *Gunëzi*, *Guribardhë*, *Gurikuq*, *Gurizi*, *Dushkakuq*, *Sikuq*, *Sojmir*, *Mensabardi*, etj. Si duket ekzistonin edhe emra të tjerë, të cilët ose u zhdukën më vonë ose disa prej tyre pësuan evoluime e përshtatje, kurse mund të ketë pasur edhe raste përkthimi nga gjuha shqipe në ndonjë tjetër. Pra, të shohim se kur u shfaqën për herë të parë këto toponime dhe si u sajuan ato gjuhësisht.

Fshati i sotëm *Ujmir-i*, që i përket komunës së Klinës, përmendet për herë të parë në Krisovulën e Deçanit në trajtën e rasës së instrumentalit të asaj kohe *Së Unjëmirom* (С.: унь·миром), që ka kuptimin *me Ujmirin*.<sup>87</sup> Pastaj këtë emër e ndeshim edhe në shekullin XV në vitet 1455 dhe 1477 e 1478 të shkruar me alfabetin turk si *Onemir* e *Onamir*.<sup>88</sup> Sot emri i këtij fshati ka trajtën dialektore shqipe *Ujmir-i* kurse që nga viti 1932 ekziston edhe dubleti *Dobra Voda*.<sup>89</sup> Sipas të gjitha gjasave ky emër me formën e sotme që ka, nëse nuk ka pësuar ndonjë evoluim, duket se është sajuar me mjete gjuhësore të shqipes. Këtë deri diku e dëshmon edhe etimologjia e trajtës së kalkuar serbokroate. Megjithëkëtë, kohëve të fundit ka përpjekje të shkencëtarëve serbë, që këtë emër ta nxjerrin si emër personal. Shkencës së onomastikës i mbetet detyrë që në studimet e mëtejme të ofrojnë zgjidhje të saktë shkencore. Këtë dukuri edhe më shpesh e ndeshim në mikrotoponime, khs. Kroni bardhë, që Nushiqi e shënon *Bele Vode* (B. Nušić, Kosovo opis zemlje i naroda, 78), kurse E. Çabeji shënon top. *Ujbardhë* (Studime gjuhësore II, f. 239)

Emri i fshatit *Buzez-i*, që gjendet në trevën e Opojës së Dragashit, është ndërtuar nga emri *buzë* dhe emri *i zi* ose *e zezë*, që në kompozitë dha *Buzez-i* (nga *buzë* + *zezë*).

Në Kadastrin e Shkodrës përmendet fshati *Buzëzezi*.<sup>90</sup> *Buzëzeshi*, fshat i paidentifikuar në Bregbunë, që gjendej në kufi me Pentarin, Belan dhe Gramshin!

<sup>86</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 149.

<sup>87</sup> L. M u l a k u, *Mbi disa toponime mesjetare shqipe*, „Onom. Kosovës”, f. 167.

<sup>88</sup> L. M u l a k u, *po aty*, f. 167.

<sup>89</sup> L. M u l a k u, *po aty*, f. 168.

<sup>90</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 229.

Këtë emër e ndeshim edhe ndër antroponime si *Jon Buzesha*,<sup>91</sup> nga fshati Kukol, që përmendet në Kadastrin e Shkodrës. Ky emër është i shtrirë edhe në vëllazëri si *Buzëzezë* (Bucceseos, kr 1274, Savasto Tanasius Bessessia, që përmendet në Kadastrin e Shkodrës më 1416)<sup>92</sup>.

Ndërkaq, emri *Buzëzez*, në Krisovulën e vitit 1348 të Car Dushanit del edhe në trajtën *Bozovci* me kalimin e *u-së* në *o* (shih Hrisovulja Cara Dušana f. 302), krahas edhe me fshatin Buzovik të Vitisë, nga *buz(ë) + ov + ik*.<sup>92a</sup> Toponimet e antroponimet me emrin *buzë*, duke u cilësuar nga një mbiemër cilësor nuk janë të rralla në gjuhën shqipe. Emra të këtillë hasim bukur shpesh, si: *Buzigatani*,<sup>93</sup> fshat në rrethin e Ulqinit, që shënon Mariano Bolica dhe fshati *Buzogjatja*,<sup>94</sup> që përmendet në vitin 1485 e *Buzëgjeku*, fshat pranë Barbullushit,<sup>94a</sup> e *Buzëmadh*, *Buzëgarë*, *Buzujë*, *Buz-hollë*, *Buzdala*, *Buzgjarpni*, *Buzulku*, *Buzujku* e *Buzuku*, që e zë ngoje E. Çabej në studimet e veta etimologjike<sup>95</sup> dhe në antroponime si *Kostë Buzala*<sup>96</sup> nga fshati Reç, që përmendet më 1416 në Kadastrin e Shkodrës dhe Buzhala, që e ndeshin sot në Drenicë e në Ferizaj.

Fshati *Smirë* i Moravës së Epërme, që bën pjesë në komunën e Vitisë ka gjasë të jetë formuar nga trajta antonimike e ndajfoljes *mirë*, *smirë*, *smirak*,<sup>97</sup> *smirëzi*, *smirëzezë*, që herë-herë paraqitet edhe në formë kompozitesh për të shprehur në mënyrë më të theksuar *smirën*, kanë kuptim të kundërt me fjalën e parme *mirë*. Në këtë tip bën pjesë edhe emri *Sojmir*<sup>98</sup> që përmendet në shkrimet e relatorëve shqiptarë dhe emrat *Gruemirë*,<sup>99</sup> që në Kadastrin e Shkodrës përmenden fshatrat *Gruemirë e Madhe* dhe *Gruemirë e Vogël*, kurse sot ekzistojnë vetëm fshatrat *Gruemirë*, në juglindje të Koplikut të Shkodrës dhe *Gruemirë Çezme*.<sup>100</sup> Emrin e këtij fshati e ndeshim edhe si antroponim si *Pjero Gruemiri*.<sup>101</sup> që përmendet si kreu i fshatit. Në shikim të parë duket se kemi të bëjmë nga *grue + mirë*, por ka mundësi që me zëshmimin e *k-ës* në *g*, të ketë prejardhjen nga *kruemirë* (*krue + mirë*) që ka ujë të mirë (shih. S. Pulaha në Defterin e regjistrit të Sanxhakut të Shkodrës)<sup>102</sup> e që e dëshmon edhe emri i ndajshuar më vonë *çezme*, si dyfishim dhe përsëritje të emrit *krue* të burimit shqip me një fjalë orientale *çezme*. Prandaj nuk kemi të bëjmë *me grue të bukur* të kafeneve të rrugës, siç mendohet nga shkencëtarët e huaj,

<sup>91</sup> *Po aty*, f. 99.

<sup>92</sup> M. Shufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 30.

<sup>92a</sup> S. Georgijević, *Etimologija imena mesta SR Srbije*, Niš, 1985, f. 38.

<sup>93</sup> *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë Veriore...* vëll. I, f. 225.

<sup>94</sup> Selami Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, Tiranë, 1974, f. 246.

<sup>94a</sup> Selami Pulaha, *vep. e cit.* f.

<sup>95</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore*, II, Prishtinë, 1976, f. 401, 404.

<sup>96</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 116.

<sup>97</sup> I. Ajeti, *Studija iz istorije albanskog jezika*, Priština, 1982, f. 152.

<sup>98</sup> *Relacione*, vëll. I, f. 255.

<sup>99</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 229.

<sup>100</sup> *Vep. cit.* 229.

<sup>101</sup> *vep. e cit.* 58.

<sup>102</sup> S. Pulaha, *Defteri i Regjistrimit të Sanxhakut të Shkodrës*, f. 338.

sepse populli shqiptar në periudhën përkatëse historike nuk kishte një civilizim të një shkalle të atillë. Megjithëkëtë, çështja e etimologjisë në këtë rast nuk e ndërron tipin e toponimit në fjalë.

Po kështu sipas kumtimit të prof. I. Ajetit në viset malore të Hotit dhe Piperit ndeshim në emërtime shqipe të katundeve të Malit të Zi, ndër të tjera edhe *Bukmir* (Bukumir), që ka origjinë shqipe *Bukëmirë*<sup>103</sup> (nga bukë + mirë), kurse në shkrimet mesjetare përmendet fshati *Bukmira*<sup>104</sup> në Dukagjin dhe në Pult, që në Kadastrin e Shkodrës e ndeshim edhe si antroponim *Gjergj Bukamiri*<sup>105</sup> përballë antroponimeve kompozitore *Jon Kimetrasha*, *Pantaleo Kimekeqi*, etj.

Toponime kompozitore të përbëra nga një emër dhe mbiemri i *bardhë* ndeshim mjaft shpesh ndër të folme shqipe si, për shembull, toponimi *Lumbardh-i*, fshat i anës së Deçanit, që në këtë të folme dialektore shqiptohet me *m̄* (mm) geminative *Lum̄ardh-i* (Lumbardhi). Ky toponim është sajuar nga emri *lum* dhe mbiemri *i bardhë*, duke u toponimizuar në trajtën e ngorosur *Lumbardh-Lumardh* i kompozuar nga *lum+bardh*, që krahasuar me toponimet *Palabardh*, gjithashtu fshat i anës së Deçanit, që konsiderohet si një patronim i toponimizuar nga *Palë+Bardhi*, e që ndër dokumente të hershme përmendet edhe si krahinë e Malit të Zi, duke u përkthyer më vonë në trajtën *Bjelopavlić*<sup>106</sup> (krahaso me antroponimin *Gin Crnoglavlić*, banues i fshatit Barbullush që e ndeshim në trajtën e kryehershme *Gjin Kryeziu*, si edhe *Kryethiu* i kalkuar në trajtën *Svinoglav*).

Një përkthim i këtillë, sipas mendimit tim, do të ketë qenë i mundshëm nga trajta e kryehershme *Gunëbardhi* në trajtën *Bellogunci*, që sot ndeshet toponimi *Beguncë*<sup>107</sup> fshat në anën e Moravës së Epërme të komunës së Vitisë, që është analog me toponimin *Gunëzi* (nga *gunë* + *ziu*), fshat pran Shëngjinit, që përmendet në Kadastrin e Shkodrës me trajtën *Gunesi*<sup>108</sup> me rrjedhojat e tij antroponimike *Bitri Gunesi*, *Lazër Gunesi*, që shprehin vetitë fiziko-etnografike të mënyrës së veshjes së tyre në një periudhë të caktuar historike të jetës blegtorale të banorëve të fshatrave përkatëse. Prandaj, nga aspekti i fjalëformimit kemi *gunë* + *bardhë* që në përkthim u reflektua në *Bello+gun+ce*, si trajtë e hibridizuar, duke rënë ll-ja *Be(ll)ogunce* u përfutua trajta *Beogunce*. Mirëpo duke rënë theksi në *é*, me kohë *o*-ja e patheksuar ra krejtësisht dhe toponimi në fjalë evoluoi në trajtën e sotme *BEGUNCË* analog me trajtat e emrave *Bellogradce* > *Bellograce* > *Beograce*, sot *BEGRACË* dhe *Strellc* > *Streoce* nëpërmjet evoluimit fonetik sllav, (shih edhe *Bellgrad*>*Belgrad*>*Berat*, qytet në Shqipërinë Jugore, M. Shufflay, *Serbët e Shqiptarët*, 84, 126), por këtu me

<sup>103</sup> I. A j e t i, *Studije iz istorije albanskog jezika*, 1982, f. 152.

<sup>104</sup> I. Z a m p u t i, *Relacione*, vëll. I (1610-1634) Tiranë, 1963, f. 505.

<sup>105</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 124.

<sup>106</sup> S. P u l a h a, *vep. cit.* f. 4.

<sup>107</sup> S. G e o r g i j e v i ć, *Etimologija imena mesta SR Srbije*, Niš, 1985, f. 34.

(skript, ku *Begunce*, jezički hibrid od *be(l)gun-ci*).

<sup>108</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 103.

evoluim fonetik të shqipes. Po kështu edhe fshati i paidnetifikuar nën Shkodër *Mensabardhi*,<sup>109</sup> që përmendet më 1417, i cili kishte 14 shtëpi, sot ndeshim toponim *Menshabardhi*.<sup>110</sup> Këtu përherë të parë më 1417 ndeshim edhe dy patronimet e vetme *Mirdit*,<sup>111</sup> në një kohë kur *Mirdita* ende nuk ishte formuar si njësi, *Gjon Mirdita* dhe *Petro Mirdita*. Edhe toponimi i fshatit *Guribardhë* në Mat që E. Çabej e sjell me trajtën *Gurabardhë*.<sup>112</sup> Sa i përket mbiemrit *i bardhë*, që ndër toponime kompozitore e ndeshim si gjymtyrë të dytë, e heq zanafillën që nga periudha ilire, të cilën e zë ngoje edhe Jiričeku,<sup>113</sup> Hans Krahe,<sup>114</sup> pra përmendet edhe te emrat ilirë *Bardus*, *Barduli*, *Bardylis* (mbret),<sup>115</sup> etj.

Toponimi i sotëm *Dushkakuq*,<sup>116</sup> që ndeshet në rrethin e Ulqinit është i përbërë nga emri *dushk* dhe mbiemri *i kuq*, pra *dushk+kuq*, ku meqë kemi të bëjmë me dyfishimin e *k*-së toponimi në fjalë është ndërlidhur me një *a* këpujore *Dushk+ a+kuq>Dushkakuq*.

Këtë tip formimi të toponimeve e ndeshim të përhapur në treva të ndryshme shqiptare si *Mollëkuçi* e *Mallëkuçi* (Malocucci) që gjendet në dioçezën e Durrësit<sup>117</sup> e *Gurakuq*,<sup>118</sup> sot fshat në krahinën e Lumës dhe *Gurikuqi* te Danja, të cilin në shkrime mesjetare e ndeshim me trajtën *Guricuchi* (Gurikuq), që në sllav. është përkthyer në „Crveni kamen.” e romanisht në „Piera Rossa”, që përmenden më 1446.<sup>119</sup>

Si duket ekzistonin edhe toponime të tjera, por të cilat më vonë u zhdukën bashkë me vendbanimet, siç ishte fshati *Sikuq*, i cili përmendej në shekullin XV.<sup>120</sup>

Edhe toponimi *Guri i Zi*,<sup>121</sup> fshat që më vonë u quajt Gurazi, që nga trajta sintagmatike u përftua trajta kompozitore, është formuar nga emri *gur* dhe mbiemri *i zi* (Gurazi, me një *a* këpujore), si *Gunëzi*, *Kryezi*, *Mali i Zi*, që dikur përmendej në rrethin e Pukës, sipas M. Shufflay-it, u përhap pastaj në tërë Zetën.<sup>122</sup>

Në toponimet kompozitore të tipit në shqyrtim bën pjesë edhe toponimi *Makramadh*,<sup>123</sup> që përmendet në Kadastrin e Shkodrës më

<sup>109</sup> Vep. cit. f. 99.

<sup>110</sup> K o l ë L u k a, *po aty*, f. 135.

<sup>111</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 135.

<sup>112</sup> E. Ç a b e j, *Studime filologjike*, nr. 3, 1979, f. 35.

<sup>113</sup> K. J i r i ć e k, *Romani*, f. 147 (cituat sipas M. Grković).

<sup>114</sup> H a n s K r a h e, *Lexikon altillyrcher, Personennamen*, Haidelberg, 1929, f. 16.

<sup>115</sup> E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore*, II, Prishtinë, 1976, f. 159.

<sup>116</sup> R. U s h a k u, *Kërkime filologjike*, Prishtinë, 1981, f. 241.

<sup>117</sup> I. Z a m p u t i, *Relacione*, vëll. II (1634-1650), Tiranë, 1965, f. 511.

<sup>118</sup> E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore*, I, Prishtinë, 1976, f. 33.

<sup>119</sup> M. S h u f f l a y, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 30.

<sup>120</sup> S. P u l a h a, *vep. cit.* f. 164.

<sup>121</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 78.

<sup>122</sup> M. S h u f f l a y, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 45 („Në rrethinën e Pukës vë në dukje krahinën *Mal'Zi*, *Malcija* (1452 *Malisium*, *Malici*), e cila në mesjetë, pos emrit shqiptar mban edhe emrin serb *Crna Gora* (1422 — Catoni dhe Cerna Gora vel Mali Ixi), te Muzaka quhet (1520) *Montagna Nera*. Kujtoj se ky emër së këndejmi u përhap në tërë Zetën”).

<sup>123</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 162.

1416-1417. Gjymtyra e parë e kompozitës është e errët, ndërsa gjymtyra e dytë është e qartë nga mbiemri *i madh*. Toponim i këtij tipi është edhe *Golemadi*<sup>124</sup> (gojëmadhi), që përmendet më 1444, e që sot gjendet në thellësi të Malit të Zi, në treva ku nuk flitet shqipja bukur moti, si emër fisi e vendi, që është ndërtuar me mjete gjuhësore të shqipes nga emri *gojë* dhe mbiemri *i madh*, duke u kompozuar në *gojëmadhi*, por në periudhën kur u huazua ndër të folme sllave, *l*-ja shqipe ende nuk kishte kaluar në *j*, siç e dëshmojnë sot shembujt *golë>gojë*, *bilë>bijë*, *klumsht>kjumsht*, etj. që në këtë formë edhe si patronim *Benko Goljamadhi*,<sup>125</sup> ku mbiemrat shpesh u shndërruan në llagape, që cilësojnë veçoritë trupore si *Burmad>Burmazović* (burrë+madh), *Camaless* (këmbëlesh), *Camamadi* (këmbëmadhi), Jon Camamadi e *chimechechi* (Kimekeqi, Gjergj Kimekeqi), që paraqitet si fshat i paidentifikuar në jug të Shkodrës me trajtën *Kimekeqi* (Qimekeqi),<sup>126</sup> *Cimetrasse* (qimetrashë), *Bisdos*, *Busadosa*, *Bitidosi*, *Bitodosi* (1415 bithdose, bythdose, podex porci),<sup>127</sup> që është bërë edhe emër fisi.

c) *Toponime kompozitore parafjalë + emër*, ku parafjala shërben si formans parashtesor, janë të rralla në toponime vendbanimesh, por mjaft të shpeshta në mikrotoponime.

Në Grudë të Malësisë së Madhe, në rrethin e Tuzit të Titogradit ndeshim fshatin *Pikalë*, që nëse merren parasysh veçoritë fonetike të kësaj të folmeje dialektore, duhet të jetë i përbërë nga fjalët *mbi+kalë*, ku togu konsonantik *mb* në përputhje me ligjet fonetike të kësaj të folmeje u asimilua në buzoren *p*, pra *mb>p* krahaso me shembujt: *me petë*, *me pajt*, *me pjell*, *me pyt*, në vend të: *me mbetë*, *me mbajtë*, *me mbjellë*, *me mbyt*, etj. Mirëpo, në përjasje me toponimin *Prekal(ë)*, për të cilin do të bëjmë fjalë më poshtë, ky shpjegim që më tepër i përngjet një etimologjie popullore, vihet pak a shumë në dyshim.

Ndërkaq te mikrotoponimi *Miubla*,<sup>128</sup> emër arash, që e ndeshim në Arbnesht të Krajës, togu konsonantik *mb* u asimilua në buzoren *m*, e jo në *p*, duke u përputhur kështu me veçoritë dialektore të së folmes së Krajës.

Kurse fshati *Prekal* i Bregbunës, që sot aty ka mbetur i vetmi *Prekal* nga të katër vendbanimet që ishin me këtë emër në shekullin XV, të cilin Škrivanić e vendon në hartën e tij, por pa e shënuar në indeksin e toponimeve.

Shikuar nga aspekti i formimit, toponimi *Prekal* sipas Kolë Lukës,<sup>129</sup> bën pjesë në tipin e toponimeve si *Dukal*, *Kalesh*, etj. *Pre+kal*, *Duk+kal*, *Kal+Lesh*, që ndoshta te defteri i vitit 1485 duhet të shohim edhe trajtën e shqiptarizuar të greqizmit *kal-kalie* „bukurosh”, që në shqipe ndeshim trajtat *Mirë*, *Mirosh* (Shih edhe fshatin *Mirash* të Kosovës që bën pjesë në komunën e Ferizajt). Këtë trajtë e ndeshim edhe te antroponimet *Gjoka i*

<sup>124</sup> M. Shufflay, *Serbët dhe Shqiptarët*, Prishtinë, 1968, f. 62.

<sup>125</sup> *Regjistri i Kadastrit të Shkodrës*, f. 105.

<sup>126</sup> *Vep. cit.* f. 229.

<sup>127</sup> M. Shufflay, *vep. cit.* f. 53.

<sup>128</sup> I. Doda, *Onomastika e Kosovës*, f. 177.

<sup>129</sup> K. Luka, *po aty*, f. 139.

*biri Bukuroshit*, në Trushin e Poshtëm dhe *Luka i biri Bukuroshit* në Gramsh. Siç del nga këta shembuj toponimi *Prekal* është një kompozitë nga *Pre(nk)+Kala* (Prenk Bukuroshi).

Po kështu toponimi *Narhelm*, fshat i trevës së Hotit, që është i vendosur buzë Liqenit të Shkodrës, e në afërsi të Tuzit, mund të jetë kompozuar nga fjalët *n(d)ër+helm*, por që në të folmen dialektore të kësaj treve shqiptohet *Narhelm*, ku *nar* përdoret në vend të *nër* (ndër), siç ndeshet edhe në krijimtari popullore: „More e mira nar foletë/Narhelm t’Tuzit po m’verosh” (Këngë dashurie I, Prishtinë 1979, 344).

Në Kadastrin e Shkodrës përmendet fshati *Andrea Schiave* (Skjave),<sup>130</sup> fshat me 10 zjarre, kurse sot ndeshet në Bushat toponimi *Ndreshkije*,<sup>131</sup> nga *(A)Ndre+shkije*, ku *skjavo* u përftua në trajtën *shkà*, shumësi *shkije*, që edhe pse nga trajta e saj fjalëformuese duket si toponim kompozitor me parashtesë parafjalore dhe emër, në fakt kemi të bëjmë me një patronim të hershëm të toponimizuar. Kurse në fshatin *Meglushë* gjenden *Arët e Shkjaut*, që të kujtojnë edhe antroponimin *Biter Shkjau*.<sup>132</sup>

Emërtimi i fshatit *Bujan*, në afërsi të Lipjanit e *Bujan* në Progonat të Kurveleshit, e në Çamëri *Bujanë* „pus i thellë, vorbull lumi”, *Bujan*, emër fshati në Tropojë, në Shqipërinë Veriore, që sipas E. Çabejt është një kompozitë nga elementet morfematike: *b+uj+anë*, kompozita nga *ujë+b*, me hipostazë *mbë+ujë*. Mirëpo, I. Ajeti nuk pajtohet me këtë shpjegim, duke parë aty vështirësi në shpjegimin e prejardhjes, sepse kjo fjalë ndeshet shpesh edhe ndër të folme serbokroate, si *bujan*, *-na*, *-no* me kuptim „i shpejtë, i fuqishëm, i rrëmbyeshëm”, por ai nuk jep ndonjë mendim të prerë lidhur me këtë çështje, ndonëse ai lejon mundësinë që të thellohet ky mendim kur përmend fjalën *bujs*, që me këtë shprehje fshatarët në Tupallë i drejtohen kafshëve që ato të pijnë ujë në mënyrë të ngadalshme e të qetë, ku sipas shpjegimit të I. Ajetit forma *bujs* është sajuar nga emri *ujë*, duke iu ndajshtuar morfema *b*, pra *b+uj+s*. Në mbështetje të këtij mendimi dhe shembujve, që sjell E. Çabej për të gjitha emërtimet për fjalët *bujanë* e *bujan*, të cilat shprehin kuptimin e kënetës e moçaleve me ujë, të rogave e pusave që mbajnë ujë amull, e në përqasje me mënyrën dhe formën e sajimit edhe të emrit *Bushat*, lejohet mundësia të mendohet që edhe fshati *Bujan-i*, i Lipjanit që gjendet në një pozitë rrafshinore me plot roga uji amull, tokë me lagështi të përhershme, që e mundojnë ujërat e reshjeve atmosferike, duke fjetur gjatë në ara vonojnë të mbjellat pranverore. Kjo pozitë e fshatit *Bujan* dëshmon se dikur ai ishte buzë kënetës, siç dëshmon edhe emri i fshatit *Lloshkobare* (nga *Vlaško+bare*), prandaj trajta *mbë+ujë*, që forma definitive duhet të ketë dalë nga trajta *uj+an* (krahaso me fjalën *ujane* për „oqean”, që është një nga sajimet e poetit arbëresh De

<sup>130</sup> Regjistri i Kadastrit të Shkodrës, f. 94.

<sup>131</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 136.

<sup>132</sup> K. L u k a, *po aty*, f. 136.

<sup>133</sup> I. A j e t i, *Studije iz istorije albanskog jezika*, f. 200.

Radës që përmend E. Çabej<sup>134</sup> me toponimet *ujanik*, *Ujmisht*, *Ujbardh*, *Ujzi*, etj.), ku *b*-ja është si morfemë shtuese *b+uj+an*, sepse togu *mb* do të ishte asimiluar në *m*, e jo në *b*, e do të kishim *Mujan* në vend të *Bujan*. Prandaj, këtu siç shihet rrënjës së emrit *uj* i është shtuar morfema *b* dhe prapashtesa *-an*, *b+uj+an > bujan*, që tregon një vend të ujshëm, baltak, kënetë ose moçal, që ekzistonte në kohën kur edhe lindi emërtimi i toponimit në fjalë, i cili mund të jetë më i vjetër se vendbanimi i sotëm.

Me rrugë të njëjtë sajimi ndeshim edhe toponimin *Bushala*,<sup>135</sup> emër katundi në Mirditë dhe *Bushat*<sup>136</sup> „emër katundesh në Shqipëri Veriore”, pastaj *Bushati i Zadrimës*, *Bushati i Bicajve* në Lumë, prej nga thuhet se rrjedhin *Bushatlinjtë* e *Shkodrës*, afër Tiranës *Bushatat* quhej një korie katundi, *Bushati në Zetë*,<sup>137</sup> të gjitha lidhen sipas Çabejt me fjalët *shat:fshat:bushat* e *shalë:bushalë*, sikurse *fshij:mshij:mbëshij*, etj.

Me të njëjtën rrënjë *shat* del edhe *fshati Nenshati*<sup>138</sup> (Ndenshati) *nën+shat*, *fshat* i *Sapës* së *moçshme*.

Sipas mendimit tim ka gjasë që edhe emri i fshatit *Zgatar* i Opojës të jetë formuar nga formansi parashtesor *z+gat+ar*, që përputhet me të folmet dialektore të kësaj treve, që e ndeshim në *shembuj i gatë* (mbiemër), *me zgatë* (folje), *zgan* e *zgatara* (me prapashtesë të dyfishtë nga *z+gat+ar+an*, që e ndeshim ndër të folme dialektore) e krahaso edhe me *zborak*, nga *borë*, *zborë* „zog bore” dhe *Zgërdhesh*, emër i një katundi afër Krujës, që lidhet me një formim të *gardhit* e me prefiks *z-* dhe me reduktimin e *a*-së së patheksuar në *ë*: *Zgërdhesh*, që paraqitet si një emër vendi më i vjetër *Gardhiq*, *Kardhiq*, ndeshet edhe trajta lokale *Zgurdhesh*, që sjell E. Çabej.<sup>139</sup> *Z-në* në funksion të prefiksit edhe në mikrotoponiminë e *Hasit*,<sup>140</sup> si *Zgadza* (arë) dhe *Zgjuza*, që emërton emër burimi, etj.

**3. Toponime kompozitore që dëshmojnë për praninë e vllëve në Kosovë.** — Në truallin e Kosovës sot ndeshim edhe disa toponime kompozitore të krijuara nga sllavofonët, por që dëshmojnë për gjurmët e popullsisë së dikurshme vllahe. Të tilla konsiderohen toponimet: *Llashadrenoci*, që e ndeshim ndër të folme dialektore shqipe, kurse trajta e serbokroatishtes ndeshet *Vlaški Drenovac*, *Lloshkobare* (nga *Vlaško Bare*), *Gllanasellë* (nga *Gladno Selo*), kurse në afërsi të fshatit *Çabiq* kishte edhe disa fshatra të tjera vllahe.

**Shënimi:** Në Krisovulat e Deçanit<sup>141</sup> përmenden edhe këto fshatra vllahe: *Ratishevci*, *Vardishtani*, *Lepçinovci*, *Sushiçani*, *Tudoriçevci* (Turiçeci

<sup>134</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore*, II, Prishtinë, 1976, f. 239.

<sup>135</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore*, I, Prishtinë, 1976, f. 85.

<sup>136</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore*, I, Prishtinë, 1976, f. 85.

<sup>137</sup> I. Ajeti, *vep. cit.* f. 155.

<sup>138</sup> I. Zamputi, *Relacione II* (1634-1650), Tiranë, 1965, f. 513.

<sup>139</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore*, Prishtinë, 1976, f. 323.

<sup>140</sup> A. Zymbëri, *Fjalëformimi dhe leksiku në mikrotoponiminë e Hasit*, „Onomastika e Kosovës” (simpozium 25-27 shkurt 1977), Prishtinë, 1979, f. 336.

<sup>141</sup> Milica Grković, *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, f. 107.

i sotëm), *Goneçje*, *Gjurashevski*, *Pagarushani*, etj. kurse në anën e Gjilanit *Llashtica* (Vlaštica) e *Makreshi* (trajta e vjetër Majgeros, Majkeros e Majkros) që gjendet në verilindje të Novobërdës,<sup>142</sup> që rumanisht *maero* „vend i thatë, pa bar”, shih Makreshena në Maqedoni. Fshatra vllahe konsiderohen edhe Sharbani, Gjinovci, Magjerci (me kuptim gjellbërës) e *Caparci*, që sot e ndeshim me emrin *Capar* në anë të Gjilanit, që arum. *tap*, do të thotë *edh*.

**4. Toponime kompozitore me origjinë turke-** — Në trevën e Kosovës ndeshim edhe një shtresë toponimesh, megjithëse mjaft të vona, me origjinë turke, të sajuara me mjete leksikore të turqishtes, si: *Karadak*, që në turqishte „*kara*” do të thotë i zi dhe „*dag*”, mal, por që me kohë u bë shurdhimi i *g*-së në *k* dhe nga *Karadag* > *Karadak*. Kur është fjala për *Karadakun* e sotëm si masiv malor, që gjendet ndërmjet Shkupit, Kumanovës, Preshevës dhe Luginës së Moravës e Gjilanit, si duket ky regjion pësoi disa përkthime prej një gjuhe në tjetrën. Në popull të kësaj ane gjëllin toponimi *Maja e Zezë*, që gjendet ndërmjet fshatrave Dunav dhe Stançiq dhe është maja më e lartë e këtij masivi malor.

Pjesa e parë e sintagmës së këtij toponimi në shqipen *majë*, semantikisht lidhet me fjalën *mal*, ku me kalimin e *l*-së në *j* u përftua fjala *majë*. Prandaj toponimi i sotëm *Maja e zezë*, që e ndeshim të lokalizuar në kuptim të ngushtë, nuk është gjë tjetër përpos reflektim i termit tani me kuptim të zgjeruar *Mali i Zi*. Ka mundësi të mendohet se termi *Maja e Zezë* mund të konsiderohet si trajtë reliktoze e ngushtuar e toponimit të lashtë *Mali i Zi*, i cili u përkthye pastaj në *Negri Monti* (cholo Sesarouich, de Negrimonte)<sup>143</sup> që e ndeshim në arkivin e Dubrovnikut dhe trajtën *Monte Negro*,<sup>144</sup> që e përmend në relacionet e veta relatori shqiptar Gjergj Bardhi, i cili me rastin e vizitave që i bënte popullsisë së konfesionit katolik, përmend edhe shumë fshatra të tjera të kësaj ane. Ky toponim në kohën e mesjetës nga administrata kishtarë sllave u quajt *Crna Gora*, e më vonë edhe *Skopska Crna Gora* për ta dalluar nga *Mali i Zi* i sotëm. Të gjitha këto varianta, në kohën e sundimit turk, u evituan, duke u përdorur trajta e kalkuar *Karadak* (nga *kara*+*dag*), që në ditët tona përdoret në të dy gjuhët e anamoravasve të shqiptarëve dhe të serbëve.

Toponimi turk *Ortakoll* (orta+koll), që *orta*, do të thotë „i mesëm” dhe *koll* „regjion”, që ka kuptimin mesoregjion, sepse gjendet ndërmjet lumit Sitnicë dhe malit Çiçavicë; *Elez-han* (hani i Elezit), që dikur ngjashëm me këtë nga administrata turke pati përpjekje që edhe Ferizaji i sotëm, zyrtarisht të thirrej *Ferizbej*,<sup>145</sup> duke e lidhur me emrin e pronarit të dikurshëm. Mirëpo ky vendbanim siç dihet ka të bëjë me emrin e Feriz Shashivarit, i cili sipas Ami Bues, aty më 1863 kishte hanin në udhëkryqin e

<sup>142</sup> *Oblast Brankovića*, Orientalni institut, Sarajevo, 1972, f. 266.

<sup>143</sup> M. D i n i ć, *Iz Dubrovačkog arhiva*, f. 74.

<sup>144</sup> I. Z a m p u t i, *Relacione mbi gjendjen...* vëll. II (1634-1650). f. 96.

<sup>145</sup> Sh. P l l a n a, *Toponimet shqipe të Kosovës, në veprën e B. Nushiçit*, „Onomastika e Kosovës” 1979 f. 420.

rrugës Shkodër-Kosovë-Shkup.<sup>146</sup> *Kuklibeg* (nga Kukli+beg), që e ndeshim në trevën e Opojës, si paralagje e fshatit më të madh Brodosanë.

Sot në Kosovë mund të ndeshim edhe gjurmë të toponimeve të zhdukura turke, si Velikoreka e sotme është quajtur *Ish-hanije zir*, kurse Bellaçevci i Madh quhej *Akqoy*, do të thotë katund i bardhë; *Is-hanije Bala*, do të thotë bamirësi, që gjendej në lokalitetin e sotëm të Stanovcit. Kurse në afërsi të Dumoshit të Llapit përmendet toponimi *Çerkez köj* si *Çerkez Sadovinë*, *Jerli Sadovinë*, *Çerkez Babush*. *Çerkez köj* ndeshim edhe në afërsi të Suhadollit të Mitrovicës së Titos. Ndërkaq, katundi *Hatmaxhe* i komunës së Prizrenit, i cili është sajuar gjithashtu me mjete leksikore të gjuhës turke, që trajta e mirfilltë e këtij toponimi është *Atmaxha* „gjueti zogjsh”.<sup>147</sup> *Küçük Babjak* (Bablaku i Vogël), sigurisht paralagje e mëparshme e Bablakut të sotëm, që gjendet në veri të Ferizajt.<sup>148</sup> Një kompleks dikur arash, sot kuart i qytetit të Prishtinës, thirret *Aktash* (ak+tash) me kuptim guri i bardhë dhe *Siktash* (sik+tash),<sup>149</sup> edhe pse shqipja ka pasur mjete të bollshme për të emërtuar toponime të kësaj natyre siç dëshmojnë shembujt toponimikë *Gurabardhë*, *Gurazi*, *Gurakuq*, etj. ajo nuk ndjek traditën e përkthimit, por ruan besnikërisht toponimet e shtresuara të periudhave të ndryshme historike.

**5. Toponime kompozitore të hibridizuara.** — Në trevën e Kosovës, përveç toponimeve kompozitore të sajuara me brum e me mjete gjuhësore të një gjuhe, ndeshim edhe toponime të kryqëzuara (madje mjaft të hershme), ku dy gjymtyrët e një toponimi i përkasin dy gjuhëve të ndryshme në kontakt. Toponim i këtillë pandehet *Bajgora*, që sipas L. Mulakut është i përbërë nga *Bajr+gorë*, njëra fjalë turke, kurse tjetra serbokroate, që rrjedhin nga një trajtë e vjetër *Bela Gora*,<sup>150</sup> ndërsa sipas S. Georgijeviqit toponimi *Bajgora*, emër fshati dhe krahine, është kompozitë hibride nga gjuha rumune dhe serbokroate, rum. *bobai* „luginë mes dy bregjesh” dhe *gora* serb. „mal”, që sipas tij kaloi nëpër fazat *bobai* > *obaj* > *baj* + *gora* = *Bajgora*.<sup>151</sup> Mirëpo, këtu vlen të përmendet se krahas mundësisë që ky toponim të ketë pasur trajtën e mundshme *Bela Gora*, do pasur parasysh edhe mundësinë e dubletit *Mali i Bardhë*, siç e ndeshim në rrethin e Ulqinit përballë toponimit *Mali i Bardhë* edhe *Bijela Gora*.<sup>152</sup>

Sot toponim hibrid konsiderohet edhe *Batahir*, fshat i Shalës së Bajgorës, që është i përbërë nga fjalët *baltë*, shqip dhe *vir*, serbokr.

<sup>146</sup> *Monografia e qytetit Ferizaj*, Ferizaj, 1975, f. 55.

<sup>147</sup> S. U k a, *Shtresa gjuhësore turke e toponimeve në rrethin e gjerë të Prishtinës dhe në vende tjera të KSA të Kosovës*, „Onomastika e Kosovës” 1979, f. 367-371 (Numri më i madh i shembujve u morën nga ky punim, siç janë: *Ortakoll*, *Akqöy*, *Çerkez köj*, *Is-hanije zir*, *Is-hanije Bala*, *Hatmaxhe*, etj.).

<sup>148</sup> *Oblast Brankovića*, f. 165.

<sup>149</sup> S. U k a, *po aty*, f. 368 (vendasi për lokalitetin e tyre *Sofali*, fshat i vogël afër Prishtinës që ishte çiflik i Jashar pashë Gjinnollit ruajnë edhe emërtimin më të vjetër *Siktash*).

<sup>150</sup> L. M u l a k u, *Govor albanaca Bajgorske Šalje*, Priština, 1968, f. 19.

<sup>151</sup> S. G e o r g i j e v i ć, *Etimologija imena mesta SR Srbije*, Niš, 1985, f. 30.

<sup>152</sup> R. U s h a k u, *Kërkime filologjike*, Prishtinë, 1981, f. 238.

*Baltavir* > *Ba(l)ta(v)ir* > *Batair*<sup>153</sup> dhe *Beguncë* nga fjala shqipe *gunë* dhe mbiemri serbokroatisht *bel, beo*, pra *Belogun* > *Beo+gunë* > *Beguncë*, duke iu shtuar sufiksi *ci(-e)* i serbokroatishtes dhe *Beguncë*,<sup>154</sup> që ka mundësi të jetë kalkuar nga *Gunëbardhi* analog me *Gunëziu* (shih fshatrat në Serbi *Gunjaci, Gunjetina, Gunjevac* dhe *Gunjica*, që sipas S. Georgijeviqit të gjitha kanë për bazë fjalën shqipe *gunë, Etimologija imena mesta Sr Srbije*, Niš, 1985, 52). Po kështu edhe emri i fshatit *Bellobrad* i trevës së Opojës konsiderohet si një hibrid nga serbokroatishtja *belo* dhe *brad* nga rumunishtja (shq. bredh), *Belobrad*, khs. me *Bradash*, fshat në anën e Llapit. Toponimi *Debelde*, fshat në anën e Karadakut të Vitisë, që është një hibrid gjuhësor serbo-rumun nga *debel+del* (rum. kodër),<sup>155</sup> kurse *Gojbulë*, fshat i komunës së Vuçitërnës nga *galbulus*, një lloj bari i verdhë, kompozitë nga *geia-bula* „gogël, kryth”, *Gojbula*.<sup>156</sup> Ndërkaq, në anën e Llapit, në Kadastrin e vitit 1455 përmendet fshati me emrin e deformuar, sigurisht në mungesë të njohjes së gjuhës nga regjistruerit, me trajtat *Bokrodol, Mokri Do* e *Mokrodol*.<sup>157</sup> Këtu lihet mundësia të dyshohet se mund të kemi të bëjmë me një toponim të qartë e me kuptim të plotë *Bukurdol*, ku pjesa e dytë e këtij toponimi i përket serbokroatishtes, ndërsa pjesa e parë ose është vllahe ose është shqipe, meqë në të dy gjuhët ka të njëjtin kuptim. Mirëpo, në mungesë të të dhënave të mjaftueshme, etimologjia e saj mbetet e pazgjidhur. Gjurmët e këtij toponimi i ndeshim sot te emri i një kullote, lëndine *Bukurdoll*, që gjendet ndërmjet fshatrave Majanc dhe Lupç i Poshtëm të trevës së Llapit dhe fshati *Bukurovac* e *Bukuroc* afër Preshevës e *Bukurov Do*, fshat në Hercegovinë, *Bukurje* (teferiq) në Likë e në Bullgari *Bukar, Bukurci*, që sipas S. Georgijeviqit kanë për bazë fjalën shqipe *bukur* „i hijshëm, i dashur dhe rum. *bucuros* „i gëzueshëm”.<sup>158</sup> Lidhur me ndikimet dhe hibridizimet e mundshme reciproke vlen të përmendim një konstantim të Çabejt: „Duke gjykuar nga dëshmitë gjuhësore ky kontakt duhet të kenë qenë mjaft intim, dhe vise-vise ka shkuar mbase gjer në simbiozë. Ai gjatë të ashtuquajturës periodë të rumanishtes së përbashkët gjanë të ketë vazhduar për disa shekuj me radhë, me siguri gjer në shkëputjen e arumunëve prej trunqum rumun të përbashkët dhe në shtegtimin e tyre për nga jugu shtegtim që u krye vonë-vonë (jo më vonë) se gjatë shekullit të X”.<sup>159</sup> Në këtë vazhdë, është me interes të veçantë të zëbërthet në pjesët e tij përbërëse toponimi i hibridizuar *Makërmal*, fshat i komunës së Serbicës, nga *Mokr+mal* khs. edhe *Mokra Gora*, që me 1477 e ndeshim në trajtën selo *Makruman*, ndërsa në vitin 1478 në trajtën *Mokrimalj*<sup>160</sup> khs. edhe me *Makramadhi*,

<sup>153</sup> S. Georgijević, *vep. cit.* f. 33.

<sup>154</sup> S. Georgijević, *vep. cit.* f. 36.

<sup>156</sup> S. Georgijević, *vep. e cit.* f. 49.

<sup>157</sup> *Oblast Brankovića*, f. 279.

<sup>158</sup> S. Georgijević, *po aty*, f. 37.

<sup>159</sup> E. Çabej, *Studime gjuhësore IV*, Prishtinë, 1976, f. 244.

<sup>160</sup> *Oblast Brankovića*, f. 44.

vend i paidentifikuar pranë Belaj në Bregbunë).<sup>161</sup> *Karashëngjergj*, nga fjalët *kara*+*shëngjergj*, fjala e parë turke dhe shëngjergj, fjalë shqipe e sferës fetare. Fshati i sotëm *Baballoç*, që gjendet në anë të Deçanit e në juglindje të Junikut deri në formimin e trajtës së sotme përfundimtare shfaqet në disa trajta të ndryshme, si *Babe*,<sup>162</sup> *Babajloç*,<sup>163</sup> *Babnoç*.<sup>164</sup> Sidoqoftë, toponimi i sotëm është i përbërë nga emri i vjetër *Babe*, që ky toponim e kishte në ballë të kohës dhe gjymtyra e dytë *lloç*, që është fjalë dialektore e shqipes për sinonimin e emrit baltë. *Lugbunar*, nga emri *lug* i shqipes dhe emri *bunar* i turqishtes. Ndërsa toponimi *Prekollukë*, si duket është i përbërë nga fjalët *preko* (e sllavishtes) dhe *lug*, emër që në Krisovulat e Deçanit ndeshet si *Prekillug* (прѣкилг) kur për fjalën *llug* Milica Gërkoviqi mendon se duhet të jetë *l u g*.<sup>165</sup> Ndërkaq, ky toponim më 1485 ndeshet në trajtën *Preklug*,<sup>166</sup> që mendohet pikërisht për *Prekollukën* e sotme, që gjendet në juglindje të Deçanit. *Llashadrenoc*, fshat i trevës së Prekorupës, që i përket gjurmëve të vllëve në Kosovë, por e formuar nga sllavofonët nga trajta e mbiemrit përcaktor *Vlaški*+*drennovac*, nga fjalët *vlah* dhe *dren* „dru thane”, që në të folmen shqipe u përftua në trajtën *(V)Llash(k)a + dreno(v)c = Llashadrenoc*. Toponime të hibridizuara në Kosovë ndeshim mjaft, sepse në këtë trevë është bërë gërshetimi i kulturave të ndryshme gjuhësore që ishin në kontakt të vazhdueshëm.

**6. Dhe në fund kemi të bëjmë me një tip toponimesh kompozitore,** që bëjnë pjesë në patronime të toponimizuara. Disa prej tyre janë bukur të hershme, që i ndeshim shpesh edhe ndër dokumente të shkruara mesjetare, kurse disa sosh janë toponime krejtësisht të reja.

Këtu do të marrim në shqyrtim disa shembuj nga kjo kategori toponimesh për të parë më konkretisht mënyrën e sajimit të tyre.

Në këtë tip bën pjesë emri i fshatit *Pclabardhi*, që gjendet në anë të Gjakovës, i sajuar nga antroponimi *Pal + Bardhi*, duke u kompozuar në trajtën e sotme të ngurosor *Palabardhi*: dy-pjesët përbërëse janë lidhur me një *a* këpujore. Ky toponim përmendet edhe ndër dokumente të hershme më 1485, por si krahinë e Malit të Zi,<sup>167</sup> që më vonë e ndeshim të përkthyer në trajtën *Bjelopavlići*.<sup>168</sup> Po kështu u sajua edhe emri i trevës *Dukagjini*, e cila lidhet me emrin e familjes *Dukagjini*, që deri në kohën e Turqisë ruante karakterin e shtëpisë së madhe, e pastaj edhe të vëllazërisë Gjin Tanushi, i cili më 1281 e mori emrin „dukë” (ducam Ginium Tanuschum Albanensem).<sup>169</sup> Një pjesë e kësaj dege kryesore të Lezhës, si pasardhës të Tanushit II Dukagjinit, të birit të Lekës I, ishin zotërues në

<sup>161</sup> *Kadastr i Regjistr i të Shkodrës*, f. 230.

<sup>162</sup> M. G r k o v i ć, *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, f. 30.

<sup>163</sup> S. P u l a h a, *vep. cit.* f. 476.

<sup>164</sup> S. P u l a h a, *po aty*, f. 80.

<sup>165</sup> M. G r k o v i ć, *Imena u Dečanskim Hrisovuljama*, f. 150.

<sup>166</sup> S. P u l a h a, *vep. cit.* f. 279.

<sup>167</sup> S. P u l a h a, *po aty*, f. 4.

<sup>168</sup> I. Z a m p u t i, *Relacione mbi gjendjen...* vëll. II, f. 503.

<sup>169</sup> M. S h u f f l a y, *Serbët dhe Shqiptarët*, f. 35.

Perlat (1402). Pas këtyre, siç thotë *Musachi*, edhe degët e tjera (questa altri Ducagini) ishin Dukagjin të vërtetë (la casa dei veri Ducagueni). I këtillë ishte (Nicolaus Tuderovich Ducaghiu, që përmendet në vitin 1377 (A. Albanie 2,340).<sup>170</sup> Këta qëndruan në Lezhë deri vonë në kohën turke si Pal Dukagjini (1591-1606). Që nga koha kur kryetari i kësaj familjeje Gjin Tanushi, fitoi titullin „dukë” (1281 ducam Gjinium), ndoshta edhe si partizan i Paleologëve bizantinë e ndoshta edhe si flamurtar e vojvodë në ushtri të mbretit serb, familja e Dukagjinasve mbajti deri në kohën turke famën e një familje të madhe të vëllazërisë. Pra, shikuar nga aspekti gjuhësor ky toponim kompozitor u sajua nga titulli *dukë*, -a „princ” dhe antroponimi *Gjin*, emër i cili u shtri pastaj në tërë trevën që ishte pronë e familjes së Dukagjinasve.

Rrëzë Anamalit, në Mal të i, gjendet fshati Vlladimir, i cili nga shqiptarët vendës thirret edhe si *Katërkollë*, e sipas disave dhe si *Kodër+Kolë*, që mbase rrjedh nga një kompozitë *katër* ose *kodër* dhe antroponimi *Kolë* (Nikollë),<sup>171</sup> që sipas mendimit tonë më e bindshme është trajta *Kodërkolë*, ku me shurdhimin e *d*-së në *t* dhe alternimin e *o*-së në *a*, që është veçori dialektore e kësaj të folmeje, u përftua trajta *Katërkollë*.

Vlen të theksohet se emërtimi i toponimeve nga pronarët e trevave ose themeluesit e fshatrave ose të lagjeve, si në mbarë popullsinë shqiptare, ashtu edhe në Kosovë është mjaft i përhapur, siç e dëshmojnë shembujt e mëposhtëm: *Murademë*, fshat i Prizrenit (nga Mura(t) + (A)demi e *Kurbali* (nga Kur(t) + Balia), *Lezbalia* (nga (E)lez+Balia), *Rexhment* (nga Rexh + Mehmet), *Zekbasht* (nga Zekë+Basha), *Ukmehmet* (nga Ukë + Mehmeti) lagje fshatrash të Karadakut të Preshevës. Toponime të këtilla ndeshim edhe në Mal të Zi, si: *Vuksanlekaj* (nga Vuksan + Lekaj), *Gjonbalaj* (nga Gjon + Bala + aj), *Prelvukaj* (nga Prel + Vuka + aj), *Omerbozhaj* dhe në vise të ndryshme të Shqipërisë, si: *Lekdush* (Lekë + Dushi), *Gjinikë* (Gjin + Nikaj), *Lekpeta* (Lekë + Peta), *Nikëgjani* (nga Nikë + Gjani), që i ndeshim si emra vendbanimesh të Krahinës së Kurveleshit<sup>172</sup> e *Kolgecaj* (nga Kolë + Gec + aj), fshat i Lumës e *Nikaj-Merturi*, si trevë e veçantë etj. Edhe në anën e Gjakovës ndeshim emrin e fshatit *Osekhylla* (Osek + Hyla).

Toponime krejtësisht të reja, që datojnë pas Luftërave Ballkanike, Luftës së Parë Botërore, e disa prej tyre ndoshta edhe më vonë, në truallin e Kosovës ndeshim emërtimet e vendbanimeve si *Serbobran* (Istog), *Vukosavljeviqi* (M. Titos), *Devetjugoviqi* (Prishtinë), *Gjeneraljankoviqi* që e ndeshim të përdoret krahas dubletit *Elez-han*, etj.

Nga shqyrtimni i deritashëm dhe spikatjet e shembujve të trajtuar del krejt e natyrshme dhe e qartë, që në një trevë ku jetuan e jetojnë popuj me përkatësi të ndryshme gjuhësore, madje edhe më gjerë në tërë Ballkanin,

<sup>170</sup> M. Shufflay, *po aty*, f. 35.

<sup>171</sup> R. Ushaku, *Onomastika e Kosovës*, f. 23.

<sup>172</sup> A. Dhrimi, *Një vështrim gjuhësor mbi toponiminë e Kurveleshit*, „Konferenca e Dytë e Studimeve albanologjike”, III, f. 301.

si rrjedhim ndeshim edhe shtresime toponimesh kompozitore të gjuhëve të nduarnduarta, ndeshim në përshtatje, evoluime e hibridizime të gjuhëve në kontakt, jo rrallë ndeshim edhe në përkthime të toponimeve, që shikuar nga aspekti i rrethanave historike janë të mundshme, por gjuhësisht janë të panatyrshme, të dhunshme e artificiale, duke lënë gjurmë në historinë e gjuhëve. Prandaj mund të thuhet se „toponimet për historinë e gjuhës janë si fosilet për palenteologun, si copat e mineralit për gjeologun. Ato ndihmojnë gjuhësinë historike për të zbuluar disa shtresa gjuhësore të lashta, të cilat janë me peshë dhe për historinë”<sup>173</sup> e popujve.

*Mehmet Halimi*

## LES TOPONYMES COMPOSÉS DU MOYEN AGE DANS LES PARLERS DU ALBANAIS

### R é s u m é

Cette étude traite des toponymes composés et de leurs formes linguistiques dans les parlers albanais d'aujourd'hui.

Aujourd'hui, à part les formes connues linguistiques de toponymes, c'est à dire à un seul composant, on rencontre au Kosovo et dans le autres parler albanais, un nombre considérable de toponymes composés, c'est à dire à deux ou plusieurs composants, qui nomment des lieux d'habitations dans les villages, villes, montagnes et d'autres contrées Il y a, dans le Kosovo, des centaines de toponymes semblables. On peut meme dire que leur nombre en serait plus grand si l'on arrivait à déchiffrer l'étymologie d'autres toponymes qui, au premier abord, ne nous semblent pas composés.

C'est pour cette raison que nous sommes efforcés, dans cette étude, d'identifier les toponymes d'aujourd'hui à partir de leur formes médiévales, en nous basant sur des écrits historiques et sur leurs formes actuelles dans les divers parlers dialectaux albanais. Cet examen a été fondé sur l'aspect diachronique et synchronique. Vu sous cet aspect, on peut suivre les formes évolutives de toute une série de toponymes slaves et anciens toponymes albanais, ainsi que leurs formes dans les parlers dialectaux, leur adaptation de l'albanais en langues slaves, et vice-versa.

Certains de ces toponymes se présentent aujourd'hui avec la même forme linguistique et dialectale qu'au Moyen Age, tandis que d'autres ont subi une évolution phonologique et morphologique. Mais, mis à part les anciens toponymes composés conservés depuis le Moyen Age, on en rencontre aussi dont la formation est totalement nouvelle.

Etant donné que, dans le passé, différents peuples, occupants ou autochtones, ont vécu et régné dans le Kosovo et que ces contrées sont encore aujourd'hui multinationales, la toponymie présente des couches linguistiques variées. Partant donc de ce fait historique, nous rencontrons des couches de toponymes d'origine slave, albanaise, vlaque, turque, des toponymes hybridisés et des toponymes nouveaux, principalement des patronymes devenus toponymes.

Du point de vue de formation linguistique, la plus grande partie des toponymes composés de lieux d'habitation est d'origine slave, comme par exemple: *Kisella Banja, Staro*

<sup>173</sup> E. Ç a b e j, *Studime gjuhësore V*, Prishtinë, 1976, f. 286.

*Sello, Stari Dvoran, Dobra Luka, Belogradce, Podgradie, Crnoljevo, Cernavrana, Cenraluka* (Çirna Luka), etc, mais que l'on rencontre en albanais sous les formes: *Sallabajë, Starasëllë e Sarasëllë, Staradran, Dobërllukë, Begracë, Pogragjë, Carralevë, Carravranë, Carallukë*.

Cependant, un nombre considérable de noms de villages et d'autres contrées sont d'origine albanaise et son écrits, dans les documents, sous les formes actuelles ou biens avec des évolutions phonétique et morphologiques, comme: *Fushë-Kosovë, Anamoravë, Ujmir, Buzez, Palabardh, Lumbardh, Gruemirë, Bukëmirë, Mirditë*, etc. Une autre partie des toponymes albanais a subit une adaptation ou une traduction en langues slaves comme, par exemple, un ancien toponyme *Kryethi* peut avoir été transmis en serbo-croate en *Svinoglav*, puis en *Svinodol*, tout comme cela a été le cas de *Ujmir*, que l'on rencontre aussi dans le doublet *Dobravoda*.

La présence des Vlaques dans le Kosove est prouvée par les toponymes composés: *Llashadrenoc* (Vlaški Drenovac), *Lloshkobare* (Vlaškobare), *Llashtëica* (Vlaštica), *Makresh, Capar*, etc.

Nous rencontrons aussi, dans le Kosove, une couche de toponymes composés d'origine turque, comme: *Karadak, Ortakoll, Elezhan, Kuglibeg, Akqöy* (Bellaçevc), *Hatmaxha, Aktash*, etc.

Il n'est pas rare de trouver des toponymes hybridisés à partir de deux langues qui ont été constamment en contact dans les contrées balkaniques, comme: *Bajgorë, Batahir, Beguncë, Bellobrad, Gojëbulë, Bukurdol, Makërmal, Karashëngjergji, Baballoç, Lugbunar, Prekollukë*, etj.

De meme, les toponymes venant de paronymes sont assez fréquents: *Palabardhi* (de Palë + Bardhi), *Dukagjini* (de Duka i Gjinit), *Kurbali* (de Kurt Bëlia), *Elezhan* (Hani i Elezit), *Osekhylla, Serbobran, Devetjugoviqi, Vukosavljeviqi*, etc.

Le coexistence de peuples de différentes langues dans ces contrées entraine la présence de plusieurs couches de toponymes composés. Il existe même des adaptations, des évolutions et des hybridations de toponymes et, souvent, des traductions qui, historiquement, ont été possibles même si, du point de vue linguistique ne sont pas naturelles mais plutôt artificielles. Par conséquent, on peut dire que les toponymes sont pour l'histoire de la langue ce que sont les fossiles pour le paléontologiste ou les minéraux pour le géologue. Ils servent à la linguistique historique à découvrir certaines couches linguistiques ancienne, qui sont importantes pour l'histoire des peuples également.

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...

... (faint text) ...  
 ... (faint text) ...